

HAFIZ ABDUD-DAIM EL-KAHEEL

**MREKULLIA NUMERIKE  
E BESMELES DHE ÇDO AJETI  
NË KUR'AN-IN FISNIK**

PJESA -II-



**HAFIZ ABDUD-DAIM EL-KAHEEL**

**MREKULLIA NUMERIKE E  
BESMELES DHE ÇDO AJETI NË  
KUR'AN-IN FISNIK**

**PJESA -II-**



**Përkthyesit nga anglishtja:**

Armend Shabani

**Recensent:**

Osman Abazi

Armend Shabani

**Korrektor:**

Osman Abazi

**Lektor:**

Armend Shabani

**Redaktor:**

Osman Abazi

Bujar Sejdiu

**Radhitja kompjuterike:**

Meritoni Bekteshi

**Kopertina:**

Meritoni Bekteshi

**KY LIBËR U BOTUA NGA FONDI I XHAMISË "HASAN EMIN"  
DHE DO TË SHITET PËR ATË FOND**

## Parathënie

Falënderimi i takon All-llahut, të Gjithëdijshmit, Krijuesit dhe të adhuruarit të vetëm me të drejtë. Lutjet, bekimet dhe paqja qofshin me të Dërguarin e fundit, vulën e pejgamberëve, me të dashurin e All-llahut, Muhammed Mustafa-në, me familjen e pastër të tij, me gratë dhe shokët e tij, si dhe me të gjithë ata besimtarë që pasojnë rrugën e tij.

All-llahu i Madhëruar thotë:

*“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij” [El-Hixhr: 9]*

*“E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotat) pos All-llahut, nëse jeni të sigurtë (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit). E mos e paçit bërë (deri më tash), e as që do ta bëni kurrë (edhe në të ardhmen), atëherë ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët” [El-Bekareh: 23-24]*

*“Thuaj: "Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, sado që do ta ndihmonin njëri - tjetrin" [El-Isra: 88]*

*“Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?” [Fussilet: 53]*

*“A nuk e meditojnë ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie” [En-Nisa: 82]*

*“Për ta ditur (për t'u dukur) se ata kanë kumtuar shpalljet e Zotit të tyre, dhe se Ai e ka përfshi atë tek ata, Ai e di sasinë e çdo gjëje që ekziston (Ai ka llogaritur çdo gjë në numër)” [El-Xhinn: 28]*

I dashuri ynë, Muhammedi s.a.v.s., duke përshkruar Kur'anin Fisnik tha:

*“Me të vërtetë All-llahu i Madhëruar e zbriti këtë Kur'an urdhërues dhe ndalues, rrugë të qartë, dhe shembull të paraqitur. Në të janë lajmet tuaja, lajmet për ata që ishin para jush dhe lajmet për ata që do të vijnë pas jush. Ai është gjykatës i juaji dhe atë nuk e konsumon kundërshtimi i gjatë. Nuk marrin fund asnjëherë çudirat e tij, ai është i vërtetë dhe nuk është lojë. Kush flet me të thotë të vërtetën; kush gjykon me të gjykon drejtë; kush debaton me të del fitimtar; kush ndanë me të ndanë drejtë; kush punon me të do të shpërblehet; kush i përmbahet atij do të udhëzohet në rrugën e drejtë, kush nuk kërkon udhëzimin tek ai do ta humb All-llahu; kush nuk gjykon me të do ta shkatërroj All-llahu. Ai është përkujtimi i urtë, drita e qartë, rruga e drejtë, litari i fortë i All-llahut dhe shëruesi i dobishëm. Ai është siguri për atë që i përmbahet, ai nuk shtrembërohet që pastaj të drejtohet dhe nuk devijon e të kthehet në rrugë” (Musannef Ibn Ebu Shejbe, Tirmidhiu, imam Ahmedi dhe Darimiu me disa ndryshime te vogla).*

Të nderuar lexues! Libri i fundit i Krijuesit të kësaj Gjithësie, Kur'ani Fisnik, është një mëshirë e pakufishme për njerëzimin, ai i hapi njerëzimit shtigjet e udhëzimit, ai është garancë i kësaj toke, ai është fjala e Krijuesit të çdo gjëje dhe ai mbërtheu në vetë dituritë e çdo gjëje. Ai është Libri më i lexuar në tokë, ashtu si nga fëmijët, që shumë nga ata e mësuan përmendësh, nga të rriturit

dhe nga gratë, atë e lexojnë ata që e besojnë, por edhe ata të cilët nuk e besojnë.

Mrekullitë Kur'anore nuk u ndalën kurrë gjatë gjithë kohës nga zbritja e tij e parë e deri më sot, ai u komentua nga mijëra e mijëra dijetarë, të më hershëm apo edhe bashkëkohor. Mrekullitë e tij janë të ndryshme, duke filluar nga ato gjuhësore, me të cilat u mahnitën poetët më të mëdhenjë të Arabisë, pastaj ato legislative, historike, filozofike, psikologjike, paralajmëruese, natyrore-shkencore, numerike, etj..

Por ajo që me të vërtetë mund të na mahnitë, në këtë kohë në të cilën ne përjetojmë një zhvillim teknologjik të madh të bazuar në kompjuterizëm dhe në shkencat matematikore, e cila gjuhë është gjuhë ndërkombëtare, është **“mrekullia numerike”** në shkronjat dhe fjalët e Kur'anit Fisnik.

Nga dëshira e madhe që të jemi shërbëtorë të fjalës së All-llahut të Madhëruar dhe që Ai të na shpërblejë në këtë dhe botën e ardhme me shpërblimet e Tijja më të mira, kemi përkthyer disa artikuj të cilët shfaqin këtë mrekulli mahnitëse të Kur'anit Fisnik.

Lus All-llahun e Madhëruar, fillimisht, që ky libër ta forcojë edhe më tutje imanin tonë dhe që të jetë stimulues për të gjithë ata që e lexojnë atë në studime dhe hulumtime të reja.

Ne e dimë që gjatë përkthimit na kanë kaluar pa i vërejtur disa gabime, qofshin ato kuptimore apo edhe teknike, duke e ditur se jemi njerëz dhe që nuk jemi të përkryer, andaj e lusim All-llahun e Madhëruar që të na falë për to. Bazuar në këtë fakt, me shumë mirënjohje i pranojmë të gjitha këshillat dhe vërejtjet lidhur me këto përkthime.

Shfrytëzoj rastin që ta lus All-llahun me sinqeritetin më të lartë t'i shpërblejë me Xhennetin më të lartë, Firdevs-in, të gjithë bashkëpunëtorët në përkthimin, recensimin, lektyrimin, korrektimin, renditjen dhe botimin e këtij libri.

Dhe në veçanti lusim All-llahun që autorin e këtyre artikujve ta shpërblejë me shpërblimet më të mira në të dy botët dhe t'i

dhurojë dituri ta vazhdueshme që të bëjë edhe më tutje zbulime të tilla në Librin e Krijuesit të Madhërishëm. Lutja jonë e fundit është: *“I tërë falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve”*. Përshëndetjet, bekimet dhe paqja qofshin me të dashurin tonë, Muhammedin s.a.v.s., me familjen, gratë, shokët dhe pasuesit e tij.

**Imam: Osman Abazi**





## KAPITULLI - I -

### MREKULLIA NUMERIKE E AJETIT TË PARË NË KUR'AN (BESMELEJA)

Në këtë pjesë, do të përjetojmë një mrekulli hyjnore në katër fjalë: vargun më të shqiptuar në jetën e çdo muslimani. Para se të ushqehemi, pimë, dhe duke lexuar Kur'an; para çfarëdo veprimi (të mirë); ne muslimanët e lexojmë këtë ajet si hyrje në jetën tonë të përditshme.

Ky është ajeti i parë në Kur'an, i njohur si “Besmeleja”:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*“Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!”*

(El-Fatiha, 1-1)

Duke përdorur gjuhën e qartë të numrave, ne do të dëshmojmë se secila shkronjë në këtë ajet bart me vete një mrekulli hyjnore, duke vërtetuar në këtë mënyrë se një ajet i tillë nuk mund të ketë qenë vepër e njeriut.

Në fund pyesim: përveç Kur'an-it, a ka ndonjë libër që të përmbaj aq shumë saktësi të fshehura numerike brenda fjalëve të tij? A mundet ndokush t'i përgjigjet realisht sfidës së Kur'an-it dhe të botoj një libër, ose edhe një kapitull si ai?

#### **Madhështia e ajetit të parë**

Besmeleja lexohet vazhdimisht nga miliona muslimanë në të gjithë botën, ajo shërben si një pararendës për të gjitha veprimet e tyre të përditshme. E përbërë nga vetëm katër fjalë arabe, leximi i saj i sjell muslimanëve rehati dhe siguri që All-llahu është Zoti dhe Mbrojtësi i tyre i vërtetë, dhe se vetëm Ai iu përgjigjet lutjeve të tyre.

Por kjo është e vërtetë vetëm për ata që e besojnë mesazhin e Kur'anit. Por çka për ata të cilët nuk e besojnë? Po në lidhje me njerëzit që janë skeptik në lidhje me Kur'anin, apo njerëzit të cilët kundërshtojnë vetë konceptin e All-llahut dhe çdo nocion të fesë për këtë çështje? Po në lidhje me njerëzit që besojnë vetëm në realitetin tekstual, në shkencë dhe në të gjitha gjërat e prekshme?

A ka mundur All-llahu të ketë vënë në këtë Libër të Tij vërtetimin tekstual se ky me të vërtetë është Libri i tij? A ka diçka në këtë Libër dhe veçanërisht në këtë ajet, që fuqishëm e vërteton jo vetëm ekzistencën e Tij, por edhe madhësitinë e vërtetë të All-llahut të Plotfuqishëm?

All-llahu i Plotfuqishëm, ashtu si ne besojmë dhe ashtu si do të përpiqemi për ta ilustruar, e ka ndërtuar tërë Kur'anin në një mënyrë që është bazuar **në mrekullinë e numrit 7**. Pa e zgatur më tutje, është koha që të thellohemi më në detaje në fshehtësitë e këtij ajeti.

## Struktura e shkronjave

Duke numëruar shkronjat në secilin prej katër fjalëve të Besmeles:

(بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ – **Bismil-lAhiRr-RrahmaniRr-Rrahim**)

saktësisht ashtu si ato paraqiten në Kur'an, gjejmë sa vijon:

- Fjala (**Bismi** - بِسْمِ) përbëhet prej 3 shkronjave (ب س م).
- Fjala (**All-llah** - اللّٰه) përbëhet prej 4 shkronjave (ا ل ل ه).
- Fjala (**Err-Rrahman** - الرَّحْمٰن) përbëhet prej 6 shkronjave (ا ر ح م ن).
- Fjala (**Err-Rrahim** - الرَّحِیْمِ) përbëhet prej 6 shkronjave (ر ا ل ح ی م).

Tani, shkruajmë Besmelen së bashku me numrin e shkronjave që përbëjnë secilën fjalë të saj:

الرَّحِیْمِ	الرَّحْمٰنِ	اللّٰه	بِسْمِ
6	6	4	3

Kështu, numri i shkronjave që e përbëjnë çdo fjalë të Besmeles, të radhitur në mënyrë logjike, jep numrin **6643**. Për të qenë më specifik, numri 3 përfaqëson numrin e shkronjave në fjalën e parë, numri 4 tregon shkronjat e fjalës së dytë, e kështu me radhë.

Por çka e bënë numrin 6643 të mbrojtur prej çfarëdo ndryshimi? Çfarë rregulli është përdorur për të shpjeguar se ky numër, si dhe të gjithë numrat tjerë që do t'i shqyrtojmë, me të vërtetë është i mbrojtur nga All-llahu i Plotfuqishëm?

Si rregull do të përdorim veprimin e njohur matematik - pjesëtimin, i cila na mundëson të gjejmë shumëfishët e numrave të caktuar. Dhe meqë kemi treguar se numri 7 është bazë e mrekullisë numerike të Kur'anit, mund të konfirmojmë se numri 6643, është shumëfish i 7. Me fjalë të tjera, rezultati i pjesëtimit të 6643 me 7 është një numër i plotë; nuk përfshinë decimale ose thyesa, përndryshe, nuk do të konsiderohej shumëfish i 7:

Në mënyrë alternative mund të shkruajmë:

$$6643 = 949 \times 7$$

Me fjalë tjera, ne jemi duke thënë që numri i shkronjave në secilën fjalë të Besmeles, kur radhiten së bashku në një numër të vetëm, formojnë numrin "gjashtëmijë e gjashtëqind e dyzetë e tre". Kjo është mënyra se si lexojmë numrat.

Në mënyrë që të jemi të qartë se si të trajtojmë mrekullinë numerike dhe interpretimin e numrave, do të zbërthejmë komponentët e këtij numri, i cili, qartë se është 4 shifror, i përbërë prej katër shifrave të ndryshme:

<b>1000 x 6</b>	<b>100 x 6</b>	<b>10 x 4</b>	<b>1 x 3</b>
<b>6000</b>	<b>600</b>	<b>40</b>	<b>3</b>
<b>Mijëshe</b>	<b>Qindëshe</b>	<b>Dhjetëshe</b>	<b>Njëshe</b>

Shuma e numrave të mësipërm është e barabartë me numrin original 6643, përputhje e cila paraqet numrin e shkronjave në çdo fjalë të Besmeles:

$$6643 = 6000 + 600 + 40 + 3$$

Kështu, kur shkruajmë numrin e shkronjave të çdo fjale të ndonjë ajeti, duke përdorur *metodën e radhitjes së numrave*, ne në të vërtetë jemi duke i numëruar veçmas shkronjat e çdo fjale, duke ia shoqëruar atë numër fjalës përkatëse, dhe pastaj lexojmë kombinimin që rezulton, i cili është numër me shifra të ndryshme (p.sh., njëshet, dhjetëshet, qindëshet, mijëshet, dhjetë mijëshet etj.). Prandaj, çdo fjalë bart *vlerën e pozitës* dhjetë herë më të madhe se fjala paraprake. Në shembullin tonë të mësipërm, numri 600 është në pozitën e qindëshes, dhe para tij është numri 40 në pozitën e dhjetëshes.

Por mund të shtrohet pyetja: pse thjeshtë nuk mund t'i mbledhim shifrat së bashku? Pse thjeshtë radhisim shifrat 6-6-4-3 në një numër të vetëm, në vend se t'i mbledhim këto 4 shifra për të fituar numrin 19 (6+6+4+3)?

Përgjigjja e thjeshtë është se edhe pse do të vinim në ndonjë rregullim të caktuar që prodhon shumëfish të 7 kur mbledhim, në të vërtetë, secili mund të krijoj një “ajet” të supozuar, të bëjë lidhjen e këtyre fjalëve së bashku për të krijuar shumëfishin e 7 dhe të deklarojë këtë se është hyjnore. Megjithatë, kjo nuk është mrekulli.

Mrekullia e vërtetë është në vendosjen e çdo fjale në vendin e saj në ndonjë ajet, shoqërimin e një numri për çdo fjalë, dhe krijimin e një marrëveshje të bazuar në atë bazë, megjithatë logjike dhe befasese. Një nga karakteristikat e kësaj metode është se rregullimi i numrave në këtë mënyrë ruan vendin e secilës fjalë brenda ajetit. Me fjalë të tjera, nëse rregulli i ndonjë fjale do të

zhvendosej, rezultati i numrit do të ndryshojë menjëherë dhe më nuk do jetë shumëfish i numrit 7.

Për shembull, vetëm për qëllim të demonstrimit, le të supozojmë që fjalët e para dhe të fundit të Besmeles janë ndryshuar. Si rezultat, shifrat e para dhe të fundit të numrit 6643 do të ndërrojnë vendet dhe do të fitojmë numrin 3646, i cili nuk është shumëfish i 7. Kjo metodë e vendosjes së numrave njëri pas tjetrit paraqet fakt që All-llahu i ka ruajtur dhe përsosur fjalët e Tij nga ndryshimi.

Përveç kësaj, radhitja e numrave është më superiore se sa mbledhja e tyre sepse numrat që rezultojnë mund të jenë shumë të mëdhenj, siç do të shohim së shpejti. Kjo vetëm e shton kompleksin dhe mrekullinë e numrave të Kur'anit. Do të shqyrtojmë numrat që përmbajnë 16 shifra, 26 shifra dhe më shumë se 100 shifra<sup>1</sup>, dhe do të shohim se ata plotpjesëtohen me 7. Kështu përmes këtyre shembujve do të vlerësojmë natyrën e vërtetë mahnitëse të rregullimit të numrave në Kur'an.

## **Rregullimi i shkronjave të fjalës “All-llah” në Besmele: një sekret i fshehur**

Për të shtuar më tepër mrekullinë mahnitëse që gjendet në Besmele, kemi gjetur që All-llahu i Plotfuqishëm i ka radhitur shkronjat e emrit të Tij (All-llah - الله) brenda katër fjalëve të Besmeles, në një mënyrë që mund të përshkruhet vetëm si tërësisht hyjnore.

Emri All-llah (الله), siç e kemi përmendur më herët, përbëhet prej 4 shkronjave: ( ه ل ل ا ). Megjithatë, ajo përbëhet prej 3 shkronjave të ndryshme, sepse shkronja “Lām” ( ل ) është përsëritur dy herë. Këto 3 shkronjat tjera të ndryshme janë “Elif” ( ا ), “Lām” ( ل ), dhe “Hā” ( ه ).

---

<sup>1</sup> Madje as duke përdorur kalkulatorin e zakonshëm nuk është e mundur të kontrollohet nëse këta numra të mëdhenj plotpjesëtohen me 7; në këtë rast duhet të përdoren kalkulator më të fuqishëm shkencor, të cilët pranojnë më tepër se 100 shifra. Shumë kalkulator direkt lejojnë kalkulime të tilla.

Tani, do të shohim këto tri shkronja në secilën nga katër fjalët e Besmeles. Me fjalë të tjera, do të marrim çdo fjalë të Besmeles dhe do të shohim sa herë këto shkronja janë paraqitur në të. Do t'i radhisim këto katër rezultate në një numër të vetëm.

Sërish, Besmeleja është ( ب س م ا ل ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م ):

Sa herë janë përsëritur shkronjat “Elif” ( ا ), “Lām” ( ل ), dhe “Hā” ( ه ), të cilat e përbëjnë emrin All-llah (الله - Zoti) në Arabisht, në secilën fjalë të Besmeles?				
بسم الله الرحمن الرحيم				
<b>Zbërthimi i shkronjave</b>	“Elif” ( ا ) “Lām”( ل ) “Rā” ( ر ) “Hā” ( ح ) “Yā” ( ي ) “Mīm” ( م )	“Elif” ( ا ) “Lām” ( ل ) “Rā” ( ر ) “Hā” ( ح ) “Mīm” ( م ) “Nūn” ( ن )	“Elif” ( ا ) “Lām” ( ل ) “Lām” ( ل ) “Hā” ( ه )	“Bā” ( ب ) “Sīn” ( س ) “Mīm” ( م )
<b>Numri i tërësishëm i “Elif” ( ا ), “Lām”( ل ), dhe “Hā” ( ه )</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>0</b>

Radhitja që rezulton, që paraqet përsëritjen e tre shkronjave të cilat përbëjnë fjalën (الله) në secilin fjalë të Besmeles, formon numrin 2240.

Ky numër, 2240, është shumëfish tjetër i 7:

$$40 = 320 \times 7$$

A nuk është kjo sikur një nënshkrim nga All-llahu i Plotfuqishëm, një konfirmim i fshehur se vetëm Ai është Autor i Kur'anit të Shenjtë?

Për të përmbledhur shkurtimisht atë që thamë: gjer tani ne kemi ardhur tek dy shumëfish të 7: i pari është 6643, i cili paraqet numrin që përbëhet prej numrit të shkronjave në secilën fjalë ndarëse të Besmeles. I dyti është 2240, një numër i cili përbëhet prej përsëritjes së tre shkronjave që përbëjnë emrin e All-llahut (الله), përsëri në secilën fjalë të Besmeles.

### **Baza shkencore e mrekullisë numerike**

Në shumë disiplina të inxhinierisë, një lëmi me rëndësi e studimit është shpërndarja e forcave të ndryshme, siç është presioni mbi trupa të ndryshëm. Për shembull, në inxhinierinë e aviacionit, në mënyrë që aeroplanët të jenë të sigurt për fluturim, shpërndarja e presionit nëpër krahët e aeroplanit duhet të studiohet me shumë kujdes, dhe nuk duhet të tejkalojë limitin e lejuar. Në mënyrë që të kryhet ky studim, çdo krahë është i ndarë në blloqe katrore, pra “elementet e fundme” janë bërë në pika të ndryshme të krahut, dhe presioni është matur në çdo element të fundmë. Numrat që rezultojnë prej këtij eksperimenti janë organizuar pastaj, para se të analizohen teknikat e ndryshme të matematikës.

Kështu, të studiuarit e radhitjes së shkronjave përgjatë fjalëve të ajeteve në shqyrtim aktualisht buron prej matematikës, dhe nuk është prodhim i improvizimit. Çdo fjale i është shoqëruar një numër dhe pozita. Për shembull, në shembullin e mësipërm rreth emrit të All-llahut në Besmelen, fjalës së parë (بِسْمِ) i është shoqëruar numri 0, sepse asnjëra nga shkronjat e emrit të All-llahut (الله) (p.sh. “Elif” (أ), “Lām” (ل), dhe “Hā” (ه) nuk ekziston në të. Gjithashtu, meqenëse është numri i parë, është vendosur në pozitën e njësheve, duke e bërë atë të parin nga katër shifrat që formojnë numrin 2240.

Për më tepër, kur studiohen radhitjet e tilla, pika e përbashkët është se numrat që rezultojnë gjithmonë janë analizuar duke iu referuar pjesëtueshmërisë së tyre me 7. Dhe çdoherë do të shohim



se këta numra vazhdojnë të jenë të plotpjesëtueshëm me 7, pa marrë parasysh se a janë të vegjël apo të mëdhenj.

Ekzistenca e rregullimit numerik në bazë të shkronjave të emrit të All-llahut të Plotfuqishëm (الله) është argument i qartë se vetëm Ai është i Cili e ka zbritur këtë ajet dhe e ka përsosur në këtë mënyrë. Dhe në qoftë se ndokush ndonjëherë ka tentuar ta ndryshojë një shkronjë të vetme, ky rregullim i ndjeshëm (shumë i ndjeshëm!) menjëherë do të dështonte.

### **Një tjetër dukuri interesante: radhitja e shkronjave së bashku**

Kur kemi shqyrtuar më herët Besmelen, ndaras kemi numëruar shkronjat në secilën prej katër fjalëve të saj dhe kemi radhitur këto rezultate njërin pas tjetrit për të formuar numrin 4 shifror 6643. Ne i radhitëm këto shifra në një numër të vetëm dhe shpjeguem përparësitë e radhitjes së numrave. Megjithëse ne përmendëm që mbledhja e numrave gjithashtu shumë shpesh prodhon shumëfish të 7, prapëseprapë ne nuk kemi mbledhur numrat. Kjo është ajo që ne do të bëjmë në vazhdim. Do të gjejmë shumën e shifrave 6-6-4-3, dhe do të formojmë një numër për të parë se a është edhe ky shumëfish i 7. Kjo më së miri është ilustruar në vijim:

Besmeleja përbëhet prej 4 fjalëve: (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ)

- Fjala e parë (**Bismi** - بِسْمِ) përbëhet prej 3 shkronjave. Kjo është shifra e parë e numrit që ne synojmë ta arrijmë.
- Fjala e dytë (**All-llah** - اللَّهُ) përbëhet prej 3 shkronjave. Por tani, ne i shtojmë shkronjat të fjalës së parë, duke na dhënë  $4 + 3 = 7$ . Kjo është shifra e dytë.
- Fjala (**Err-Rrahman** - الرَّحْمَنِ) përbëhet prej 6 shkronjave. Duke e mbledhur këtë me totalin paraprak ( $7 + 6$ ), merret numri 13; 1 dhe 3 tani janë shifra e tretë dhe e katërtë.
- Fjalët (**Err-Rrahim** - الرَّحِيمِ) përbëhet prej 6 shkronjave. Duke vazhduar të njëjtin model, ( $6 + 13 = 19$ ), nënkupton se 1 dhe 9 janë shifra e pestë dhe e gjashtë.

الرحيم	الرحمن	الله	بسم
6+6+4+3	6+4+3	4+3	3
19	13	7	3

Kështu, numri që morëm është 191373. Dhe sërish, ky numër është shumëfish i numrit 7.

$$191373 = 27339 \times 7$$

Edhe më interesant është fakti se anasjelltas këtij veprimi sërish prodhon shumëfish të numrit 7. Kjo nënkupton se nëse marrim shumë e shifrave, por kësaj radhe nga e majta në të djathtë, sërish do të merret një numër që plotpjesëtohet me 7.

Numri që rezulton është 6121619; dy herë shumëfish i 7:

$$6121619 = 124931 \times 7 \times 7$$

Duke vështruar këtë, ne kemi gjetur se prej cilitdo drejtim që ne i numërojmë shkronjat, rezultati i numrave edhe më tutje e ruan shumëfishin e numrit 7!

Ne duhet të vazhdojmë me një tjetër rregullim të thellë në lidhje me Besmelen, vetëm këtë herë, ne shqyrtojmë atë në relacion me emrat e ndryshëm të All-llahut të Plotfuqishëm.

### **Simetria e thellë me shkronjat e emrave tjerë të All-llahut.**

All-llahu i Plotfuqishëm e ka organizuar Librin e Tij në një mënyrë të tillë saqë askush nuk mund të përpilojë diçka të tillë, madje dhe vetë Kur'an, në shumë ajete, shpreh shkëlqimin e vetë dhe shpall se asnjë libër nuk mund të krahasohet me të.

Natyrisht, natyra e mrekullisë së Kur'anit nuk është e kufizuar vetëm në mrekullinë numerike, kjo thjesht është vetëm një nga zbulimet e reja të mrekullive të këtij Shkrimi të Shenjtë.

Mrekullitë e Kur'anit përfshijnë dhe përmbajnë të gjitha fushat e diturisë , qoftë ato të letërsisë , linguistikës, shkencës, historisë, psikologjisë, etikës, dhe të tjera.

Të kthehemi tek mrekullia numerike, e cila është temë e këtij libri; All-llahu i Plotfuqishëm ka rregulluar shkronjat dhe fjalët e Kur'anit në mënyrën më unike të mundshme. Dhe një nga rregullimet më sfiduese është rregullimi i shkronjave të emrave të ndryshëm të All-llahut në gjuhën Arabe. Përsëri, ne kemi të bëjmë me gjuhën arabe pasi është gjuha e Kur'anit, e cila gjuhë sot flitet nga miliona njerëz në tërë globin, kështu që kësaj rregulle nuk mundemi dhe nuk duhet kurrë t'i shmangemi.

Në Besmele (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ) janë të paraqitur 3 nga 99 emrat e All-llahut në gjuhën Arabe. Këta janë (اللَّهُ) (“All-llah” ose Zoti), (الرحمن) (“ERr-Rahman” i Gjithëmëshirshmi), dhe (الرحيم) (“ERr-Rahim” Mëshirëploti).

Ne tashmë jemi dëshmitarë të rregullimit mahnitës të numrave të përqendruar në numrin 7 në raport me emrin e parë , (اللَّهُ). Por çfarë ndodhë me dy tjerët? A ka ndonjë rregullim të ngjashëm?

Ashtu si vepruam me emrin (اللَّهُ) (All-llah), tani do të marrim emrin (الرحمن) (ERr-Rahman) dhe do të shikojmë përsëritjen e 6 shkronjave të saj në secilën prej 4 shkronjave të Besmeles. Në mënyrë të ngjashme, do të marrim fjalën (الرحيم) (ERr-Rahim), duke shikuar përsëritjen e 6 shkronjave të saj në secilën nga 4 fjalët e Besmeles.

Gjithashtu do të zbulojmë disa njohuri në mrekullinë numerike, bazuar në faktin se numrat që ne arrijmë nganjëherë plotpjesëtohen me 7 në drejtime të ndryshme. D.m.th. ka raste kur numri plotpjesëtohet me 7, kur lexohet prej të djathtës në të majtë në vend se prej të majtës në të djathtë. Por në çdo rast, logjika dhe sistematika e natyrës së rezultateve ruhet.

**Rregullimi i shkronjave të emrit (Err-Rrahman - الرحمن - Mëshirëploti)**

Sa herë shkronjat “Elif” (أ), “Lām” (ل), “Rā” (ر), “Hā” (ح), “Mīm” (م), dhe “Nūn” (ن), të cilat e përbëjnë emrin e All-llahut (الرحمن - Mëshirëploti) në Arabisht, përsëritet në secilën fjalë të Besmeles?				
	(الرحيم)	(الرحمن)	(الله)	(بسم)
<b>Zbërthimi i shkronjave</b>	“Elif” (أ) “Lām” (ل) “Rā” (ر) “Hā” (ح) “Yā” (ي) “Mīm” (م)	“Elif” (أ) “Lām” (ل) “Rā” (ر) “Hā” (ح) “Mīm” (م) “Nūn” (ن)	“Elif” (أ) “Lām” (ل) “Lām” (ل) “Hā” (ه)	“Bā” (ب) “Sīn” (س) “Mīm” (م)
<b>Numri total i “Elif” (أ), “Lām” (ل), “Rā” (ر), “Hā” (ح), “Mīm” (م), dhe “Nūn” (ن)</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>1</b>

Para se të shpjegojmë pse numri rezultues 5631, i lexuar në anën tjetër 1365, paraqet një shumëfish të numrit 7:

$$1365 = 195 \times 7$$

**Rregullimi i shkronjave të (Err-Rrahim - الرحيم - Mëshiruesi)**

Sa herë shkronjat “Elif” (أ), “Lām” (ل), “Rā” (ر), “Ḥā” (ح), “Yā” (ي) dhe “Mīm” (م), që përbëjnë emrin e All-llahut (الرحيم - Mëshirëplotë) në gjuhën Arabe, përsëriten në çdo fjalë të Besmeles?				
	(الرحيم)	(الرحمن)	(الله)	(بسم)
<b>Zbërthimi i shkronjave</b>	“Elif” (أ) “Lām” (ل) “Rā” (ر) “Ḥā” (ح) “Yā” (ي) “Mīm” (م)	“Elif” (أ) “Lām” (ل) “Rā” (ر) “Ḥā” (ح) “Mīm” (م) “Nūn” (ن)	“Elif” (أ) “Lām” (ل) “Lām” (ل) “Hā” (ه)	“Bā” (ب) “Sīn” (س) “Mīm” (م)
<b>Numri total i “Elif” (أ), “Lām” (ل), “Rā” (ر), “Ḥā” (ح), “Yā” (ي), dhe “Mīm” (م)</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>1</b>

Renditja e shkronjave të emrit (Err-Rrahim - الرحيم) ne ajetin e Besmeles prodhon numrin 6531, shumëfish i numrit 7:

$$6531=933 \times 7$$

Këto zbulime numerike vënë në pah një model interesant kur japim përfundime për numrat Kur’anor: numrat që analizohen dhe numrat që fitohen, kur numri lexohet nga ana e kundërt. Në Besmele janë prezent tre emra të All-llahut. Shkronjat e Emrit të

parë (الله) (All-llah) në secilën fjalë të Besmeles prodhuan shumëfish të 7, nëse numri lexohet nga e majta në të djathtë. Shkronjat e emrit të dytë (الرحمن) (I Gjithëmëshirshmi) prodhuan gjithashtu shumëfish të 7, nëse numri lexohet nga e djathta në të majtë. Shkronjat e emrit të tretë (الرحيم) (Mëshiruesi) prodhuan shumëfish të 7, nëse lexohet nga e majta në të djathtë. Nëse e ilustrim këto në raport me drejtimit e leximit të tyre vërejmë:

الرحيم	الرحمن	الله
→	←	→

Këto drejtime logjikisht të kundërta (p.sh. djathtas, pastaj majtas dhe prapë djathtas) të treguara më sipër paraqesin pamundësinë e koincidence. Sikur numrat të cilët kemi arritur në mënyrë të ishin në mënyrë të rastësishme shumëfish të numrit 7, drejtimit nga të cilat lexojmë secilin numër nuk do të kishin shumë rëndësi. Mirëpo ajo që e bën interesant është se secili nga tre numrat do të mund të lexoheshin vetëm në bazë të këtyre drejtimeve, që do të thotë se drejtimit në anën e kundërt nuk do mundeshin të anashkalohen. Dhe kjo është vetëm një nga shumë shembuj që nxjerrin një përfundim të njëjtë: të kundërtat e logjiksme.

### **Fjala e parë dhe e fundit e Besmeles**

Pasi ishim dëshmitar se shkronjat mund të rregullohen në ajetin e Besmeles dhe se edhe më tej ruhet plotpjesëtimi i tyre me numrin 7, do të pyesim: a janë këto kombinime të mjaftueshme që këtë ajet ta konsiderojmë të perfeksionuar dhe të konfirmojmë se ky ajet nuk mund të ketë ndryshuar kurrë? Ne besojmë ashtu, mirëpo fatmirësisht ka ende gjëra për t'u treguar.

## Shkronjat e fjalës së parë dhe të fundit të Besmeles

Rregullimi numerik i bazuar në numrin 7 po ashtu është gjetur në mes të fjalës së parë dhe të fundit të Besmeles. Fjala e parë (بِسْمِ) përbëhet nga 3 shkronja, kurse fjala e fundit (الرَّحِيمِ) përbëhet nga 6 shkronja. Rregullimi duket si vijon:

الرَّحِيمِ	بِسْمِ
6	3

Kombinimi i lartshënuar formon numrin 63, e që është shumëfish i numrit 7:

$$63 = 9 \times 7$$

Prandaj, pa ndonjë problem mund të themi që fillimi dhe mbarimi i Besmeles në të vërtetë janë të lidhura, por në fakt, kjo nuk është e vetmja lidhje. Të lexojmë më tutje:

## Përsëritja e fjalës së parë dhe të fundit në Besmele

Ajo çka në të vërtetë është mahnitëse është se fillimi dhe mbarimi i Besmeles janë të ndërlidhura me tërë Kur'anin, dhe kjo lidhje sërish bazohet në numrin 7. Për të përshkruar atë, do ta shikojmë përsëritjen e fjalëve të para dhe të fundit të Besmeles, pra fjalët (Bismi - بِسْمِ) dhe (Err-Rrahim - الرَّحِيمِ) në tërë Kur'anin. Vërejmë se fjala (بِسْمِ) citohet 22 herë, gjersa fjala (الرَّحِيمِ) përsëritet 115 herë.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Muhammad Fuad Abdul Baki, ed., *Al-Muajam-al-Mufahras Li-Alfazil Quranil Kareem* (Shabb Press, 1945). Ky është fjalor gjithëpërfshirës indeksor i të gjitha civateve të çdo fjalë në Kur'anin e Shenjtë. Vëreni se fjala (الرَّحِيمِ) është përsëritur 115 herë, dhe kjo përsëritje përfshinë këtë fjalë në forma të ndryshme si (رَحِيمًا) dhe (رَحِيمًا) (që të dyja nënkuptojnë të njëjtën: I Mëshirshëm).

الرحيم	بسم
115	22

Sërish, duke kombinuar këta numra fitojmë 11522, i cili është shumëfish i numrit 7:

$$11522 = 1646 \times 7$$

Pasi kemi gjetur këtë, mund të përfundojmë se mrekullia numerike e Kur'anit nuk kufizohet vetëm në shkronjat e disa fjalëve të zgjedhura; ajo ngërthen edhe përsëritjen e atyre fjalëve përgjatë tërë Kur'anit. Gjithsesi, bukuria e kësaj mrekullie në numra qëndron në faktin se nuk fokusohet vetëm në disa ajete, por zgjerohet në tërësi të këtij Libri të Shenjtë.

Gjithashtu, nuk duhet t'i shmangemi vështirimit për faktin se këta numra lehtë mund të kontrollohen nga cilido që është i interesuar ta bëjë një gjë të tillë. Nuk ka gjëra të fshehta këtu; por thjeshtë, janë logjikisht të nxjerra drejtpërdrejtë nga Kur'ani, pa shtuar apo hequr diçka. Duke pasur parasysh këtë fakt, a ka njeri – përgjatë tërë historisë së njerëzimit – të ketë pasur sukses në editimin e Kur'anit të Shenjtë në përmasat më të vogla, e që kjo të mos konsistojë në pamundësinë e kombinimeve që i përmendëm më parë.

Duke konsideruar këtë, aspekti tjetër i bukur i mrekullisë numerike është bazuar në numrin 7, fjalë të ndara, ajetet dhe kaptinat duken në mënyrë të pashmangshme të lidhura njëra me tjetrën. Njëra nga këto lidhje të bukura, që do ta studiojmë me radhë, është ajo e ajetit të parë (Besmeleja) dhe ajetit të fundit të Kur'anit.



## Ajeti i Parë dhe i Fundit i Kur'anit

Marrëdhënia mes ajetit të parë Kur'anor, pra Besmeleja, dhe atij të fundit është mahnitëse. Ajeti i fundit është ajeti i 6-të i sures En-Nas:

"من الجنة والناس"

(En-Nas, 114:6)

Baza e kësaj lidhjeje si gjithnjë është numri 7. Ne tash do të paraqesim një seri të fakteve që përshkruajnë dhe plotësojnë bukurinë e rregullimit që ngjajnë mes këtyre dy ajeteve.

### Fakti 1

Njëra lidhje mes ajetit të parë dhe atij të fundit të Kur'anit është në kuptimin e numrit të ajeteve dhe numrit të fjalëve. Siç është përmendur më herët, ajeti i parë (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ), është ajeti 1 dhe përbëhet nga 4 fjalë. Ajeti fundit (من الجنة والناس) është ajeti i 6 dhe ai po ashtu përbëhet nga 4 fjalë. Këta na japin katër numra, që do të rregullohen – në mënyrë logjike – në një numër të vetëm:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
4 fjalë + ajeti 1 = 41
من الجنة والناس
4 fjalë + ajeti 6 = 46

Nëse i ndërlidhim numrat e mësipërm merret **4641**, e që është shumëfish i numrit 7.

$$4641 = 663 \times 7$$

Kjo ndërlidhje e veçantë mes ajeteve të fillimit dhe të fundit në Kur'an na tregon se Allahu i Gjithëfuqishëm ka organizuar me kujdes si numrat ashtu edhe fjalët e ajetit të parë dhe të fundit në mënyrë konsistente me numrin 7. Ne besojmë se kjo demonstroi precizitet të lartë të Kur'anit, dhe një kujdes i tillë aq delikates nuk do mund të ishte vepër e njeriut.

Megjithatë, teknikisht, edhe pse jo shumë e mundshme, rregullimi i mësipërm ka mundur të jetë i shumëfish i numrit 7 në mënyrë të rastësishme. Sigurisht, një shumëfish i numrit 7 nuk mjafton për të vërtetuar saktësinë e marrëdhënies në mes të ajetit të parë dhe atij të fundit të Kur'anit. Për ta evituar mundësinë e rastësisë, do të ju prezantojmë më shumë argumente numerike që forcojnë dhe konfirmojnë këtë marrëdhënie.

## Fakti 2

Kësaj radhe, ne do t'i shtojmë numrat e kaptinave në kombinimin e bërë në Faktin 1. E që është ajeti i parë në Kur'an dhe i cili gjendet në kaptinën 1 dhe ajeti i fundit është në kapitullin 114. Duke i shtuar këta dy numra kombinimit të mësipërm arrijmë në këtë rezultat:

$$46 \text{ (numri i fjalëve + numri i ajetit në kaptinën e fundit)} + 114 \text{ (numri i kaptinës)}$$

$$41 \text{ (numri i fjalëve + numri i ajetit në kaptinën e parë)} + 1 \text{ (numri i kaptinës)}$$

Numri 8-të shifrorë që rezulton, pra numri **46114411**, është i plotpjesëtueshëm me numrin 7:

$$46114411 = 6587773 \times 7$$

*Shënim: Pasi i përmendëm numrin e kaptinave, ekziston një lidhje madje nëse e marrim vetëm numrin e kaptinave. Pasi që kaptina e parë është Kaptina 1 dhe ajo e fundit është Kaptina 114, nëse i radhisim këta dy numra fitohet  $1141 = 163 \times 7$ . Me fjalë të tjera, edhe një shumëfish i numrit 7.*

### Fakti 3

Nëse procedojmë më tutje me dy faktet e lartpërmendura, i përfshijmë edhe numrat e shkronjave të secilit ajet dhe shohim se si edhe më tej qëndron konsistenca e plotpjesëtimit.

**13 (numri i shkronjave të ajetit të fundit) + 46 (numri i fjalëve të ajetit të fundit + numri i atij ajeti) + 114 (numri i kaptinave) + 19 (numri i shkronjave të besmeles) + 41 (numri i fjalëve të ajetit të parë + numri i atij ajeti) + 1 (numri i kaptinës):**

Numri që rezulton është 12 shifror: **134611419411**. Ai, paraqet shumëfish të numrit 7:

$$134611419411 = 19230202773 \times 7$$

### Fakti 4

Secili nga dy ajetet, i shqyrtuar në vete, përmban gjithashtu edhe rregullimin bazuar në numrin 7. Ajeti i parë (Besmeleja) ka katër numra të ndryshëm, siç është përmendur më lartë. Këta janë kaptina **1**, ajeti **1**, **4** fjalë dhe **19** shkronja. Prandaj, nëse marrim në konsideratë vetëm ajetin e parë, do të kemi:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ																
ب	س	م	ا	ل	ه	ا	ل	ر	ح	م	ا	ل	ر	ح	ي	م
<b>19 shkronja + 4 fjalë + 1 ajeti i parë + 1 kaptina e parë</b>																

Numri rezultues, **19411** është shumëfish i numrit 7.

$$19411 = 2773 \times 7$$

### Fakti 5

E njëjta vlen kur marrim ajetin e fundit të Kur'anit, pra:

مِنَ الْجَنَّةِ وَالنَّاسِ												
م	ن	ا	ل	ج	ن	ة	و	ا	ل	ن	ا	س
<b>13 shkronja + 4 fjalë + 6 ajeti i gjashtë + 114 numri i kaptinës</b>												

Numri **1346114** është shumëfish i numrit 7.

$$1346114 = 192302 \times 7$$

Një gjë që nuk duhet harruar është renditja logjike e përdorur gjatë renditjes së numrave. Së pari vjen numri i kaptinës, dhe secila kaptinë përmban ajete. Pastaj vjen numri i ajetit, dhe secili ajet përmban fjalë. Pastaj vjen numri i fjalëve dhe secila fjalë përmban shkronja, e që logjikisht përfundojmë që numri i shkronjave vjen e fundit. Shkurtimisht në fillim radhitet numri i kaptinës, pastaj i ajetit, i pasuar nga fjalët dhe në fund i pasuar nga shkronjat. Kjo renditje është prej anës së djathtë kah e majta, sigurisht, pasi që

teksti i cili është shkruar Kur'ani është në gjuhën Arabe, e që lexohet nga e djathta në të majtë.<sup>3</sup>

Gjithashtu vini re saktësinë e mahnitshme të këtij rezultati: nëse numri i kaptinave, numri i ajeteve, numri i fjalëve apo numri i shkronjave të ajeteve të përmendura më lartë do të ishin ndryshe, këto rezultate perfekt menjëherë do të bëheshin jo valide, pasi që rezultatet e tyre më nuk do të ishin shumëfish i numrit 7.

## Fakti 6

Ajeti i parë në Kur'an (بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ), përbëhet nga 10 shkronja të ndryshme Arabe (duke mos numëruar ato që përsëriten). Meqë ky ajet përmban 19 shkronja, qartë se disa shkronja përsëriten. Në mënyrë që lexuesit jo-Arab folës t'i identifikojnë dhe t'i numërojnë të gjitha shkronjat, ne kemi ndarë komplet katër fjalët e Besmeles:

م	ي	ح	ر	ل	ا	ن	م	ح	ر	ل	ا	ه	ل	ل	ا	م	س	ب
19	18	17	16	15	14	13	12	11	10	9	8	7	6	5	4	3	2	1
10 - ي , 9 - ن , 8 - ح , 7 - ر , 6 - ه , 5 - ل , 4 - ا , 3 - م , 2 - س , 1 - ب																		

Në renditjen zbritëse (pra duke u nisur nga shkronjat që përsëriten më së shumti), do t'i rendisim këto 10 shkronja të ndryshme, dhe do të shënojmë se sa herë secila prej tyre përsëritet në Besmele.

Shkronja “Lām” (ل) në Besmele përsëritet **4** herë.

Shkronja “Elif” (ا) përsëritet **3** herë.

Shkronja “Mīm” (م) përsëritet **3** herë.

Shkronja “Rā” (ر) përsëritet **2** herë.

<sup>3</sup> Është pikërisht drejtimi i kundërt i të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhën Angleze dhe në shumë gjuhë të tjera.

Shkronja “Hā” (ح) përsëritet 2 herë.

Shkronja “Bā” (ب) përsëritet 2 herë.

Shkronja “Sīn” (س) përsëritet 1 herë.

Shkronja “Hā” (ه) përsëritet 1 herë.

Shkronja “Nūn” (ن) përsëritet 1 herë.

Shkronja “Yā” (ي) përsëritet 1 herë.

Numri i cili përcakton përsëritjen e secilës shkronjë në Besmele është 1111122334, dhe ky numër 10-shifror është shumëfish i numrit 7.

$$1111122334 = 158731762 \times 7$$

Ky kombinim gjen rrënjët e tij në matematikë, më saktësisht në statistikë. Principi i radhitjes së numrave në “vargun rritës ose zbritës” është teknikë shumë e çmuar që përdoret në mënyrë efektive në të gjitha disiplinat shkencore, për të përcaktuar modelet, pozicionet dhe praktikisht gjithçka që kërkon një renditje logjike. Në mënyrë shumë interesante, Kur’ani i Shenjtë duket që të ketë filluar të vë themelet e saj.

### **Fakti 7**

Është e mahnitshme, kur shohim se i njëjti rregullim perfekt është gjetur kur i adresohemi ajetit të fundit në Kur’an, (من الجنة والناس). Edhe këtu, ne do t’i zbërthejmë tërësisht të gjitha fjalët në këtë ajet:

س	ا	ن	ل	ا	ه	ن	ج	ل	ا	ن	م
12	11	10	9	8	7	6	5	4	3	2	1
6 - س , 5 - ه , 4 - ل , 3 - ا , 2 - ن , 1 - م											

Më poshtë është paraqitur përsëritja e tetë shkronjave të këtij ajeti, në renditjen zbritëse:

Shkronja “Elif” ( ا ) përsëritet 3 herë.

Shkronja “Nūn” ( ن ) përsëritet 3 herë.

Shkronja “Lām” ( ل ) përsëritet 2 herë.

Shkronja “Mīm” ( م ) përsëritet 1 herë.

Shkronja “Jīm” ( ج ) përsëritet 1 herë.

Shkronja “Hā” ( ه ) përsëritet 1 herë.

Shkronja “Wāw” ( و ) përsëritet 1 herë.

Shkronja “Sīn” ( س ) përsëritet 1 herë.

Numri që rezulton, **1111233**, sërish paraqet shumëfish të numrit 7.

$$1111233 = 1587319 \times 7$$

Një rregullim shumë i bukur tjetër ndërlidh numrin e shkronjave në secilën fjalë të këtij ajeti të fundit Kur’anor. Më herët, kur numëruam shkronjat e secilës prej 4 fjalëve të Besmeles, arritëm tek numri 6643, shumëfish i 7-it. Në të njëjtën mënyrë do të veprojmë me ajetin e fundit Kur’anor.

Fjala ( من ) përbëhet nga 2 shkronja ( م ن )

Fjala ( الجنة ) përbëhet nga 5 shkronja ( ا ل ج ن ه )

Fjala ( و ) përbëhet nga 1 shkronja ( و )

Fjala ( الناس ) përbëhet nga 5 shkronja ( ا ل ن ا س )

Numri **5152**, si edhe numri 6643 është shumëfish i numrit 7.

**Konkludim: të gjitha rregullimet që kanë të bëjnë vetëm me ajetin e parë dhe të fundit të Kur'anit**

1. Për të dy ajetet, rregullimi i numrit të shkronjave në çdo fjalë rezulton në shumëfish të 7.
2. Për të dy ajetet, rregullimi i përsëritjeve të çdo shkronje në ajet (në drejtim zbritës) rezulton në shumëfish të 7.
3. Duke kombinuar numrin e kaptinave të dy ajeteve në një numër të vetëm rezulton në shumëfish të 7.
4. Duke kombinuar numrin e ajeteve dhe numrin e fjalëve të dy ajeteve në një numër të vetëm rezulton në shumëfish të 7.
5. Duke kombinuar numrin e kaptinave, numrin e ajeteve, dhe numrin e fjalëve të dy ajeteve në një numër të vetëm rezulton në shumëfish të 7.
6. Duke kombinuar numrin e kaptinave, numrin e ajeteve, numrin e fjalëve dhe numrin e shkronjave të ajetit të parë në një numër të vetëm rezulton në shumëfish të numrit 7.
7. Duke rregulluar numrin e kaptinave, numrin e ajeteve, numrin e fjalëve dhe numrin e shkronjave të ajetit të parë në një numër të vetëm rezulton në shumëfish të 7, dhe e njëjta vlen edhe për ajetin e fundit.

Të gjitha rregullimet të prezantuara më lartë janë të një natyre të thellë që sigurisht provokojnë një sërë pyetjesh: si është e mundur që këto rregullime gjithmonë të rezultojnë me shumëfish të 7-it? A ka mundur njeriu, para më shumë se 14 shekujsh, të ketë fshehur një sistem preciz numerik të tillë? Nëse po, pse ai kurrë nuk e ka përmendur një gjë të tillë? Apo është Zoti i Gjithëfuqishëm që rregulloi të gjitha? Këtu më nuk ka vend për mendime. Në çfarëdo rasti, Zoti i Gjithëfuqishëm në Kur'an thotë:



37. Nuk është e logjikshme të mendohet se ky Kur'an është i trilluar prej dikujt pos All-llahut, por është vërtetues i asaj (shpalljes) që ishte më parë, dhe sqarues e komentues i librit. Nuk ka farë dyshimi se është (i zbritur) nga Zoti i botëve.

*“Përkundër kësaj, ata (idhujtarët) thonë se atë e trilloi ai (Muhammedi). Ti thuaj: "Silleni pra ju një kaptinë të ngjashme me këtë, madje thirrni kë të doni në ndihmë, pos All-llahut, po qe se jeni të drejtë në atë që thoni" (Junus, 10:37-38).*

### **Lidhje e posaçme me “Shkronjat Speciale” në fillim të kaptinave të Kur’an**

“Shkronjat Speciale” që kemi përmendur në Pjesën 2, përmbajnë në vete një sërë rregullimesh shumë mirë të ndërlidhura me plotpjesëtimin me numrin 7. Këto shkronja formojnë “frazat të veçanta” që gjenden në ajetet hyrëse të 29 kaptinave të Kur’anit. Disa prej tyre përsëriten, por gjithsejtë ekzistojnë 14 fraza të veçanta të ndryshme. Prandaj, rëndësia e tyre nuk mundet të injorohet.

Këtyre frazave u jemi referuar si “të veçanta” sepse kuptimi i plotë që gjendet prapa tyre ende nuk është kuptuar plotësisht. Shumë njerëz që kanë ardhur për ta kritikuar vlefshmërinë e Kur’anit të Shenjtë kanë pohuar se këto fraza janë të pakuptimta dhe të dykuptimta. “Tefsire” të ndryshme, e që janë shpjegime të këtyre ajeteve, kanë treguar faktin që këto janë në të vërtetë disa nga mrekullitë e Kur’anit, por që All-llahu i madhëruar e di më së miri kuptimin e tyre. Megjithatë, ne do t’i përkushtojmë atyre një kapitull të tërë, në mënyrë që të analizojmë këto shprehje të veçanta në raport me numrin 7. Meqë tashmë po merremi me ajetin e parë të Kur’anit, do ta shqyrtojmë lidhshmërinë e Besmeles me frazën e parë të veçantë të Kur’anit, e që është (الم – Elif, Lam, Mim).

## Përsëritja e shkronjave speciale në Besmele

E para nga shprehjet speciale që gjendet në Kur'an është (الم – Elif, Lam, Mim), dhe paraqet ajetin e parë të kaptinës së dytë të Kur'anit, Sures El-Bekare. Në vijim do të vështrojmë se si ky ajet është i ndërlidhur me Bismelen (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ), në një mënyrë konsistence me numrin 7.

Ajeti i veçantë (الم) përbëhet nga 3 shkronja: “Elif” (أ), “Lām” (ل) dhe “Mīm” (م). Tash do të parashtrojmë pyetjen: a ka mundësi që këto shkronja të përsëriten në ajetet e para të Kur'anit në atë mënyrë që prodhon plotpjesëtimin me numrin 7?

Në besmele, shkronja “Elif” (ا) përsëritet 3 herë, shkronja “Lam” (ل) 4 herë dhe shkronja “Mim” (م) 3 herë. Për të gjithë të interesuarit që nuk mund të lexojnë në gjuhën Arabe, i kemi ndarë shkronjat e Besmeles (ب س م ا ل ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م), në shkronja individuale, ashtu që të lehtësohet identifikimi i tyre. Me pak fjalë, rregullimi duket si vijon:

ا	ل	م
3	4	3

Përsëritjet e këtyre 3 shkronjave të veçanta në Besmele formojnë 343, numër ky i barabartë me  $(7 \times 7 \times 7)$ :

$$343 = 7 \times 7 \times 7$$

## Numri i fjalëve

Një tjetër përputhshmëri në mes të (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ) dhe (الم) është në raport me numrin e fjalëve të këtyre dy ajeteve.

Besmeleja përbëhet nga 4 fjalë, dhe ( الم ) është vetëm 1 fjalë, duke na dhënë kështu:

الم	بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
“Fraza e parë e veçantë” në Kur’an	Ajeti i parë në Kur’an
Numri i fjalëve	Numri i fjalëve
1	4

Qartë se numri 14, është shumëfish i 7-it.

$$14 = 2 \times 7$$

### Numri i ajeteve dhe numri i fjalëve

Besmeleja është ajeti i parë i sures El-Fatiha, dhe përbëhet nga 4 fjalë dhe 19 shkronja. Fraza e veçantë ( الم – Elif, Lam, Mim) është ajeti i parë i sures El-Bekare, dhe përbëhet nga 1 fjalë dhe 3 shkronja.

Të rregulluarit e këtyre numrave na jep:

Elif, Lam, Mim - الم			بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ - Besmeleja		
“Fraza e parë e veçantë” në Kur’an			Ajeti i parë në Kur’an		
Shkronjat	Fjalët	Ajeti	Shkronjat	Fjalët	Ajeti
3	1	1	19	4	1

Numri 3111941 dy herë është shumëfish i 7.

$$3111941 = 63509 \times 7 \times 7$$

## Numrat e kaptinave

Numrat e kaptinave të cilave u takojnë këto dy ajete po ashtu formojnë shumëfish të numrit 7. Besmeleja gjendet në kaptinën 1, kurse ( الم ) në kaptinën 2:

الم	بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
“Fraza e parë e veçantë” në Kur’an	Ajeti i parë në Kur’an
Numri i kaptinës	Numri i kaptinës
2	1

Madje edhe këta dy numra të vegjël na japin shumëfish të numrit 7, pra numrin 21.

$$21 = 3 \times 7$$

## Numri i kaptinave dhe numri i ajeteve

Shembulli paraparak ka nevojë edhe për një hap. Nëse i shtojmë numrin e ajeteve rregullimit, e dijme se që të dyja, Besmeleja dhe fraza e veçantë ( الم ) janë ajete 1 i kaptinave përkatëse:

الم		بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ	
“Fraza e parë e veçantë” në Kur’an		Ajeti i parë në Kur’an	
Numri i ajetit	Numri i kaptinës	Numri i ajetit	Numri i kaptinës
1	2	1	1

Numri 1211 është gjithashtu shumëfish i numrit 7.

$$1211 = 173 \times 7$$

Bazuar në të gjitha rastet numerike që i përmendëm më lartë mund të përfundojmë se mrekullia Kur'anore e numrave është tejet kreative; nuk duket se kufizohet vetëm në disa rregullime numerike specifike. Me fjalë të tjera, rregullimet e ndryshme të numrit të kapitujve, numrit të ajeteve, numrit të fjalëve dhe numrit të shkronjave mundësojnë plotpjesëtimin me numrin 7. Në disa raste, kemi përdorur vetëm një ndryshore. Shpesh kemi përdorur dy, tre apo të katër ndryshoret. Sidoqoftë, rezultati ka qenë gjithmonë i njëjtë, dhe vargu logjik i kaptinave, ajeteve, fjalëve dhe shkronjave ka qenë, është dhe gjithmonë do të jenë të ruajtura.

### Ndërlidhja mahnitëse me shkronjat e fjalës “Kur’an”

Fjala Arabe “Kur’an”, pra (القرآن), përbëhet nga pesë shkronja të ndryshme: “Elif” (ا), “Lām” (ل), “Kāf” (ق), “Rā” (ر) dhe “Nūn” (ن). Katër nga këto shkronja (p.sh. të gjitha përpos “Kāf”) gjenden në Besmele. Në mënyrë interesante, shkronjat e fjalës Arabe “Kur’an” ndërlidhen me ajetin e parë të Kur’anit! Që ta vërejmë këtë, do të shënojmë Besmelen, dhe numrin e shkronjave të “Elif” (ا), “Lām” (ل), “Kāf” (ق), “Rā” (ر) dhe “Nūn” (ن).

ب س م ا ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م - ا ل ق ر ا ن

Sa herë shkronjat “Elif” (ا), “Lām” (ل), “Kāf” (ق), “Rā” (ر) dhe “Nūn” (ن), e të cilat formojnë fjalën (القرآن) - (Kur’an) - përsëriten në Besmele?

ا	ل	ق	ر	ا	ن
بسم الله الرحمن الرحيم					
Numri total: 3430					

Numri i cili përfaqëson përsëritjen e shkronjave të fjalës Arabe “Kur’an” në ajetin e parë të Kur’anit është numri 3430. Për çudi, edhe ky numër është tre herë shumëfish i 7.

$$3430 = 10 \times 7 \times 7 \times 7$$

Duket që Zoti i Gjithëfuqishëm, përmes gjuhës së numrave – dhe veçanërisht përmes gjuhës së numrit 7 – na konfirmon se ky Kur’an nuk është tjetër pos Fjalë e Tij, sepse një rregullim i tillë nuk do mund të paraqitej spontanisht, por është si rezultat i urtësisë së Tij të pakufishme.

Dhe tash të vështrojmë më afër për dy emrat e Zotit: dy emrat që janë përmendur në Besmele: (الرحمن - الرحيم) (**I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti**).

Në këta dy emra – të cilat janë dy nga 99 emrat e All-llahut – gjendet një sekret shumë i mrekullueshëm. Le të reflektojmë tani në disa rregullime shumë të bukura, veçanërisht ato të cilat ndërlidhen me përsëritjen dhe rregullimin e shkronjave të këtyre dy emrave, një shenjë se si Zoti i Plotfuqishëm në Kur’anin e Shenjtë ka perfeksionuar madje edhe shkronjat e para të emrave të Tij.

### **Përsëritja e secilit emër në Kur’an**

Zoti i Gjithëfuqishëm ka përsëritur këta dy emra në Kur’an në mënyrë të atillë që ndërlidhen me numrin 7. Duke iu referuar fjalës (الرحمن – Er-Rrahman), do të gjejmë se përsëritet 57 herë në Kur’an, derisa fjala (الرحيم – Er-Rrahim) përsëritet 115 herë<sup>4</sup>. Tash do t’i kombinojmë këta dy numra së bashku:

<sup>4</sup> Siç kemi cekur më herët, në lidhje me fjalën (الرحيم), 115 përsëritjet gjithashtu përfshijnë edhe forma të tjera të të njëjtës fjalë, që nënkuptojnë “I Mëshirshëm”, pra (رحيما) dhe (رحيما)

(الرحيم)	(الرحمن)
115	57

Numri 11557 është shumëfish i numrit 7.

$$11557 = 1651 \times 7$$

### Përsëritja e çdo shkronje

Fraza (الرحمن الرحيم) (I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti) përbëhet nga shtatë shkronja të ndryshme: “Elif” (أ), “Lām” (ل), “Rā” (ر), “Ḥā” (ح), “Mīm” (م), “Nūn” (ن), dhe “Yā” (ي). Përsëritja e këtyre shkronjave përgjatë tërë Besmeles, (بسم الله الرحمن الرحيم), përmban në vete një rregullim shumë të thellë numerik. Për hir të lehtësisë, më poshtë do t’i paraqesim zbërthimin e fjalëve të Besmeles.

Tash do t’i shkruajmë secilën nga këto shkronja të ndara, si dhe numrin se sa herë janë përsëritur në Besmele.

1 = ي	1 = ن	3 = م	2 = ح	2 = ر	4 = ل	3 = ا
-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

Dhe tash do t’i ndajmë këta dy emra (الرحمن الرحيم), në shkronja veç e veç, dhe nën çdo shkronjë, do të shkruajmë numrin sinjalizues që gjetëm më lartë, që paraqet numrin e përsëritjeve të shkronjës e cila gjendet në Besmele:

م	ي	ح	ر	ل	ا	ن	م	ح	ر	ل	ا
3	1	2	2	4	3	1	3	2	2	4	3

Numri dymbëdhjetë shifror, 312243132243, në të vërtetë është shumëfish i numrit 7.

$$312243132243 = 44606464749 \times 7$$

Madje edhe kur i shoqërojmë çdo shkronje një numër në varg, pra (1, 2, 3, 4, 5...), arrijmë tek shumëfishi i numrit 7:

الرحمن الرحيم											
12	11	10	9	8	7	6	5	4	3	2	1

Edhe numri 121110987654321 është shumëfish i numrit 7.

$$121110987654321 = 17301569664903 \times 7$$

### Shkronja e parë dhe e fundit e secilit emër

Duke shfrytëzuar shembullin paraprak, kur paraqesim rregullimin duke përdorur shkronjat e para dhe të fundit të emrave gjejmë edhe një shumëfish të numrit 7. D.m.th. rendi i shkronjës së parë në (الرحمن) është 1 dhe rendi i shkronjës së fundit është 6. Rendi i shkronjës së parë në (الرحيم) është 7 dhe rendi i asaj të fundit është 12:

الرحمن الرحيم			
12	7	6	1

Numri 12761 është shumëfish i numrit 7:

$$12761 = 1823 \times 7$$

### Numërimi i Besmeles

Në Kur'anin e shenjtë, saktësisht gjenden 114 Besmele. Sidoqoftë, vetëm dy numërohen si ajete; të tjerat janë të vendosura para



fillimit të çdo kaptine<sup>5</sup>, por që nuk konsiderohen ajete në Kur'an. Kështu që, nëse ndokush lexon Kur'an, ai ose ajo do ta gjejë Besmelen para fillimit të gati çdo kaptine, edhe pse këto besmele nuk konsiderohen ajete (disa komentues të Kur'anit i konsiderojnë ato ajete). Dy Besmelet e numëruara janë:

1. Në Suren El-Fatiha: (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ), kuptohe ky është ajeti i parë i sures El-Fatiha.
2. Në Suren En-Neml ( kaptina: Milingona):

*"Ajo (gruaja - Belkisa) tha: "O ju pari, mua më ka arritur një letër madhështore!" (e lexova) Kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) "Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirë Bërësit!" (Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim!). (në vazhdim shkruan) "Të mos u mbani në të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (dhe besimtarë)!"*

(En-Neml, 27:29-31).

Kjo Besmele është në ajetin 30 të sures En-Neml.

Rregullimi i këtyre dy numrave të ajeteve, të vetëm atyre dy Besmeleve që gjenden në Kur'an, sjell plotpjesëtimin me numrin 7:

<b>Ajeti En-Neml</b>	<b>Ajeti El-Fatiha</b>
<b>30</b>	<b>1</b>

Numri 301 është shumëfish i numrit 7.

$$301 = 43 \times 7$$

<sup>5</sup> Me përjashtim të kaptinës 9, sure Et-Tevbe (kaptina: Pendimi), e cila nuk përmban fare Besmele para ajetit të saj të parë.

## El-Fatiha dhe En-Neml

Ekziston marrëdhënie në mes të sures El-Fatiha dhe sures En-Neml (dy kaptina që përmbajnë Besmelen), në kuptimin e numrit të kaptinave dhe numrit të ajeteve:

En-Neml		El-Fatiha	
Numri i Ajeteve	Numri i Kaptinave	Numri i Ajeteve	Numri i Kaptinave
93	27	7	1

Si përfundim merret 932771, shumëfish i numrit 7:

$$932771 = 133253 \times 7$$

## El-Fatiha dhe Et-Tevbe

Nëse vështojmë edhe më tutje në ajetet e Kur'anit, gjejmë se në të është një kaptinë në të cilën Besmeleja nuk gjendet në fillim: surja Et-Tevbe (kaptina: Pendimi). Duket se pothuajse është vendosur në kundërshtim me natyrën e Kur'anit, dhe në kundërshtim me të gjitha kaptinat tjera të Kur'anit. Siç e cekëm më lartë, në mes të Sures El-Fatiha dhe Sures Et-Tevbe gjithashtu ekziston lidhshmëri me numrin 7, e që është e ngjashme me shembullin paraprak. Sidoqoftë, aty gjendet një diferencë e dukshme: kjo marrëdhënie plotësohet vetëm kur lexojmë numrat nga ana e kundërt:

سورة التوبة		سورة الفاتحة	
Et-Tevbe		El-Fatiha	
Numri i ajeteve	Nr. i kaptinës	Numri i ajeteve	Nr. i kaptinës
129	9	7	1

Numri 129971 nuk është shumëfish i numrit 7. Sidoqoftë nëse rendisim numrat nga e djathta në të majtë, kemi 179921, një shumëfish i numrit 7.

$$179921 = 25703 \times 7$$

### **En-Neml dhe përmendja e dyfishtë e Besmeles**

Surja En-Neml është e vetmja kaptinë Kur'anore ku Besmeleja gjendet dy herë: njëherë në fillim të kaptinës dhe njëherë në ajetin e 30-të. Kështu që, ekziston një marrëdhënie unike mes ajetit të parë dhe të fundit të kësaj kaptine. Qartë se ajeti i parë është ajeti 1, dhe i fundit është ajeti 93.

<b>Numri i ajetit të fundit</b>	<b>Numri i ajetit të parë</b>
<b>93</b>	<b>1</b>

Numri 931 është dy herë shumëfish i numrit 7.

$$931 = 19 \times 7 \times 7$$

Madhështia e këtij rezultati duhet të admirohet. Së pari, numri 931 është dy herë shumëfish i numrit 7, duke referuar përmendjen dy herë të Besmeles në këtë kaptinë. Së dyti, numri 19 është i përfshirë në këtë rezultat final, dhe siç përmendëm më lartë, pjesë e madhësisë së këtij numri është se vetë besmeleja përbëhet nga 19 shkronja!

## **Besmeleja, “El-Muavvedhetejn” (المعوذتين) dhe bukuria e lartë e numrave**

Tani do të vijmë tek një marrëdhënie ndër më thelbësoret që paraqet Besmeleja me kaptinat tjera në Kur'an. Ajo marrëdhënie është me dy suret e fundit të Kur'anit: surja El-Felek (الفلق) dhe surja En-Nas (الناس), të njohura si “El-Muavvedhetejn” ose dy kaptinat “kaptinat e mbrojtjes”. Tash do shohim se shkronjat e Besmeles formojnë lidhshmëri me këta dy kapituj në mënyrë të papërshkrueshme.

### **Surja El-Felek dhe Bemseleja**

Njëra nga bukuritë e shumta të Besmeles është lidhshmëria e shkronjave të saj me fjalët e kaptinave të tjera, dhe i tillë është rasti me “El-Muavvedhetejn”, pra me suret El-Felek dhe En-Nas. Së pari fillojmë me kaptinën e parafundit, kaptinën 113 në Kur'an, suren El-Felek.

Në mënyrë që të krijojmë marrëdhënien, duhet të numërojmë sa shkronja të Besmeles gjenden në çdo fjalë të Sures El-Felek. Vërejmë që kjo kaptinë përbëhet nga 26 fjalë, që nënkupton se numrin që jemi duke kërkuar do jetë mjaft i madh, në fakt numri më i gjatë deri më tani. Pyetja më pastaj do jetë se a është ky numër 26 shifror i plotpjesëtueshëm me 7.

Më herët, kemi shqyrtuar fjalët Arabe sikur (القرآن) “Kur'an”, (الله) “All-llah, (الرحمن) I Gjithëmëshirshmi”, dhe (الرحيم) “Mëshirëploti”, dhe kemi numëruar se sa herë shkronjat e atyre fjalëve ishin të përsëritura në katër fjalët e Besmeles, duke formuar kështu gjithmonë numër katër shifror. Kësaj radhe, ne jo vetëm që do ta bëjmë të kundërtën e saj, por do e kërkojmë edhe paraqitjen e shkronjave të Bemseles në tërë kaptinën!

Siç thamë më lartë, Besmeleja apo (بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ), përbëhet nga 10 shkronja të ndryshme:

ي	ن	ح	ر	ه	ل	ا	م	س	ب
10	9	8	7	6	5	4	3	2	1

Më pastaj vjen surja El-Felek:

1. *Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit,*
2. *Prej dëmit të çdo krijese që Ai e krijoi.*
3. *Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht.*
4. *Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjën nyja.*
5. *Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron.*

(El-Felek, 113)

Fjala e parë e sures El-Felek është (قل) “Thuaj”. Ajo përbëhet nga dy shkronja, (ق) dhe (ل). Prandaj, njëra nga shkronjat e Besmeles, (ل), gjendet në këtë fjalë, që do të thotë ia caktojmë numrin 1, i cili formon numrin e parë të rregullimit tonë. Për të paraqitur edhe një shembull, fjala e tretë në këtë kaptinë është (برب) “në Zotin e” 6 tre shkronjat e së cilës janë (ب), (ر) dhe (ب). Shkronjat e Besmeles (ب) dhe (ر) të dyja gjenden në këtë fjalë, që do të thotë se ia caktojmë numrin 3, sepse shkronja (ب) gjendet dy herë dhe shkronja (ر) vetëm një herë.

Më poshtë do të paraqesim numrin të cilin e fitojmë nga fjalët e sures El-Felek duke nxjerrë nga ato se sa shkronja të Besmeles përmbajnë (Shënim: kur fjalët Arabe shkruhen, shkronjat e tyre ndërlidhen, disi në mënyrë kursive (standarde) në gjuhën Angleze! Prandaj për hir të lexuesit tonë që nuk ka ndonjë njohuri bazike për gjuhën Arabe, kemi shkruar çdo fjalë përgjatë zbërthimit të

<sup>6</sup> “në Zotin e” është fjalë e vetme në gjuhën Arabe.

shkronjave të saj, që këto të mund të krahasohen me shkronjat e Besmeles, të cituar më lartë):

Fitojmë numrin 22312021312012212012123311, i cili nuk është asgjë tjetër vetëm se një shumëfish i numrit 7:

$$22312021312012212012123311 = 3187431616001744573160473 \times 7$$

### Ndarja e sures El-Felek: edhe më tepër shumëfish

Kur analizojmë suren El-Felek mund ta ndajmë në dy segmente:

- 1- Duke kërkuar strehim nga Zoti i Gjithëfuqishëm (Kul eudhu bi rabbil-felek): Kjo është e cekur në ajetin e parë: ***“Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit”***(El-Felek, 113:1).
- 2- Duke kërkuar strehim nga e keqja dhe veprimet e këqija nga krijesat e Zotit (Min sherri ma halek): Kjo është gjetur në pjesën tjetër të vargjeve në kaptinë: ***“Prej dëmit të çdo krijese që Ai e krijoi. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht.*** (El-Felek, 113 : 2-3).
- 3- Duke kërkuar strehim nga e keqja e veprave të njerëzve (Ve min sherrin-neffathati fil-ukad ve min sherri hasidin idha hased): Kjo është gjetur në ajetin e 4 dhe të 5: “4. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryejnë nyja. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron” (El-Felek, 113 : 4-5).

Në mënyrë të mrekullueshme gjejmë një rregullim bazuar në numrin 7 në çdo segment të tyre të ndarë:

- 1- Tani, duke marrë segmentin e parë në vete gjejmë se shpërndarja e shkronjave të Besmeles në të na jep numrin **3311**. Numri 3311 është shumëfish i numrit 7:

$$3311 = 473 \times 7$$

- 2- Ngjashëm, marrim segmentin e dytë të vetmuar dhe fitojmë numrin e shpërndarjes së Besmeles në to 1221201212. Numri 1221201212 është shumëfish i numrit 7:

$$1221201212 = 174457316 \times 7$$

- 3- Edhe në segmentin e tretë mbetet e njëjta rregull, aty me rastin e shpërndarjes së shkronjave të Besmeles në të do të fitojmë numrin 223120213120, i cili numër është shumëfish i numrit shtatë, po ashtu:

$$31874316160 \times 7 = 223120213120$$

### **Kategorizimi i fjalëve të sures El-Felek**

Të gjitha rregullimet perfekt të cilat i pamë nuk mund të jenë vetëm një ko incidencë, por, në shikimin tonë modest, paraqesin një mrekulli të Zotit të Plotfuqishëm.

Për të siguruar edhe më tepër vetën, do të bëjmë një vështrim më të thellë në fjalët e sures El-Felek, dhe duke i kategorizuar ato në bazë të shkronjave të Besmeles që ato përmbajnë.

Në këtë mënyrë kemi tre kategori:

1. Fjalët që përmbajnë vetëm një shkronjë të Besmeles, si p.sh. (Kul - قل), gjithsej janë 9 fjalë të tilla.
2. Fjalët që përmbajnë dy shkronja të Besmeles, si p.sh. (Birabbi - براب), gjithsej janë 10 fjalë të tilla.
3. Fjalët që përmbajnë tre shkronja të Besmeles, si p.sh. (Ilah - الله), gjithsej janë 4 fjalë të tilla.

Kështu që kushdo që dëshiron të bindet mund t'i numëroj ato gjatë vështrimit në suren El-Felek dhe shkronjat e Besmeles në çdo fjalë të saj. Tash duke rregulluar tre numrat e lartshënuar, numrat 9, 10 dhe 4 – së bashku do të arrijmë si vijon:

Tre shkronja	Dy shkronja	Një shkronjë
4	10	9

Sigurisht që, numri 4109 është i plotpjesëtueshëm me 7:

$$4109 = 587 \times 7$$

Tani do të paraqesim një pyetje kritike: A kanë mundur që në mënyrë të rastësishme të rregullohen vetë shkronjat e Besmeles përgjatë sures El-Felek, në atë mënyrë tepër perfekt dhe të krijojnë këtë raport me numrin 7? A ka mundur që rastësia në fjalë të shkojë edhe më tepër, duke rregulluar shkronjat e Besmeles në çdo segment të ndarë të sures El-Felek në të njëjtën mënyrë dhe rastësisht të formojë një rregullim aq perfekt, bazuar në numrin e fjalëve të sures El-Felek që përmbajnë një, dy apo tre shkronja të Besmeles dhe që ruajnë rregullën e shumëfishimit me numrin 7?

Nëse e tërë kjo do ishte koincidençë (që e cila, në mënyrë shumë të prerë, nuk është aspak e mundur), a do të ishte e mundur që i njëjti rregullim të gjendej edhe në suren En-Nas, kaptina që vjen menjëherë pas sures El-Felek, e dyta e “El-Muavvedhetejn” (dy kaptinat e kërkimit të mbrojtjes) dhe kaptina e fundit e Kur’anit të Shenjtë?

Le ta shikojmë pra.

### Surja En-Nas dhe Besmeleja

Duke shfrytëzuar hapat e njëjtë si në suren El-Felek, fillojmë analizimin e sures En-Nas – kaptinën e fundit të Kur’anit – duke shënuar fjalët e kësaj kaptine me numrin e shkronjave të Besmeles në çdo fjalë. Shkronjat e Besmeles janë:

ب س م ا ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م



**Numri i cili përfaqëson** shkronjat e Besmeles nëpër të gjitha fjalët e kësaj sure është:

**504251133551253525311**

Në të vërtetë, ky numër aq i madh, sikur simotra e saj në suren El-Felek, është i plotpjesëtueshëm me 7:

**504251133551253525311 = 72035876221607646473 x 7**

**Ndarja e sures En-Nas: edhe më tej shumëfish i numrit 7**

Ngjashëm siç vepruam me suren El-Felek, edhe suren En-Nas mund ta ndajmë në dy segmente:

**Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu i Plotfuqishëm**

*“Thuaj: "Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve! Sunduesin e njerëzve. Të adhuruarin e njerëzve”* (En-Nas, 114:1-3).

**Kërkojmë mbrojtje prej shejtanit të mallkuar:**

*“Prej të keqes së cytësit që fshihet. I cili bën cytje në zemrat e njerëzve. Qoftë ai (cytësi) nga xhinët ose nga njerëzit”* (En-Nas, 114:4-6).

Ngjashëm siç vepruam në suren El-Felek, sërish konsiderojmë çdo segment<sup>7</sup> në vete, duke numëruar shkronjat e Besmeles në secilën fjalë.

**Segmenti i parë**

Në këtë segment fitojmë numrin 53525311, i cili është shumëfish i numrit 7:

<sup>7</sup> Vërejmë se në suren El-Felek, segmentin e dytë e ndamë në dy segmente, por te surja En-Nas i kemi vetëm dy segmente.

$$53525311 = 7646473 \times 7$$

### Segmenti i dytë

Kurse këtu rezultati i rregullimit jep numrin 5042511335512, i cili paraqet shumëfish të numrit 7:

$$5042511335512 = 720358762216 \times 7$$

### Kategorizimi i fjalëve të kaptinës En-Nas

Tani do t'i kategorizojmë fjalët e sures En-Nas në bazë të shkronjave nga Besmeleja që ato përmbajnë. Kemi pesë kategori:

1. Fjalët që përmbajnë vetëm një shkronjë të Besmeles janë 5 fjalë.
2. Fjalët që përmbajnë dy shkronja të Besmeles janë 3 fjalë.
3. Fjalët që përmbajnë tre shkronja të Besmeles janë 4 fjalë.
4. Fjalët që përmbajnë katër shkronja të Besmeles, e që është i vetmi rast, pra gjendet vetëm 1 fjalë e tillë.
5. Fjalët që përmbajnë pesë shkronja të Besmeles janë 7 fjalë.

Prandaj:

Pesë shkronja	Katër shkronja	Tre shkronja	Dy shkronja	Një shkronjë
7	1	4	3	5

Ky rregullim rezulton në numrin 71435, shumëfish i numrit 7:

$$71435 = 10205 \times 7$$

Këto rezultate mahnitëse portretizojnë bukurinë e konsistencës dhe ndërlidhjen e rregullimeve numerike Kur'anore. Ishim

dëshmitar të një rëndësie kritike të shkronjave të Besmeles, të cilat në ajete dhe kaptina të ndryshme të Kur'anit prodhuan rezultate që plotpjesëtoheshin me numrin 7. Ndjeshmëria e llogaritjeve të tilla nuk do fjalë; nëse ndonjë numër do ishte disi më ndryshe, nuk do mundnim të arrinim tek plotpjesëtimi me 7. Kjo qartë konfirmon që jo vetëm Besmeleja është fjala e All-llahut të Plotfuqishëm, por që ajetet tjera që janë ndërlidhur me Besmelen gjithashtu janë me të vërtetë Fjalë të Zotit të Gjithëmëshirshëm.

Duke vazhduar lidhjen e shkronjave të bukura të Besmeles përgjatë pjesëve të ndryshme të Kur'anit të Shenjtë, tani do të shqyrtojmë prezencën e këtyre shkronjave në një ajet tjetër, ajet ky që është interpretuar si **“Ajeti më i Madh në tërë Kur'anin e Shenjtë”**.

### **Ajeti më i Madh në Kur'anin fisnik**

Muslimanët shumë mirë e dinë që ajeti më i Madh në Kur'an, siç na ka treguar Pejgamberi Muhamed (a.s.), është (Ajetul-Kursi)” (Ajeti i Fronit), i cili është ajeti i 255-të në suren El-Bekare<sup>8</sup>:

*“All-llahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është Mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumi, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij, e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij (dija-sundimi) përfshijnë qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi”* (El-Bekare, 2:255).

Pasi që tashmë kemi zbuluar lidhje të mahnitshme midis shkronjave të Besmeles dhe ajeteve dhe kaptinave të ndryshme, kemi ndierë se një lidhje e tillë e thellë do të ishte pashmangshme edhe kur bëhet fjalë për ajetin më të madh të Kur'anit.

---

<sup>8</sup> Vërejmë se Ajeti i Fronit është ajet i gjatë. Në fakt, është shumë më i gjatë se disa kaptina të Kur'anit, por prapëseprapë është vetëm një ajet!

Sa për ilustrim, më poshtë do i paraqesim shkronjat e Besmeles:

ب س م ا ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م

Tash do të shkruajmë "Ajetul-Kursin" së bashku me shkronjat e Besmeles të cilat gjenden në secilën fjalë të saj:

الله (ال ل ه)	لا (ل ا)	اله (ال ه)	الا (ال ا)	هو (ه و)	الحي (ال ح ي)	القيوم (ال ق ي و م)	لا (ل ا)	
4	2	3	3	1	4	4	2	
تأخذه (ت ا خ ذ ه)	سنة (س ن ه)	و (و)	لا (ل ا)	نوم (ن و م)	له (ل ه)	ما (م ا)	في (ف ي)	السموت (ال س م و ت)
2	3	0	2	2	2	2	1	4
و (و)	ما (م ا)	في (ف ي)	الأرض (ال ا ر ض)	من (م ن)	ذا (ذ ا)	الذي (ال ذ ي)	يشفع (ي ش ف ع)	عنده (ع ن د ه)
0	2	1	4	2	1	3	1	2
الا (ال ا)	بأذنه (ب ا ذ ن ه)	يعلم (ي ع ل م)	ما (م ا)	بين (ب ي ن)	أيديهم (ا ي د ي ه م)	و (و)	ما (م ا)	
3	4	3	2	3	5	0	2	
خلفهم (خ ل ف ه م)	و (و)	لا (ل ا)	يحيطون (ي ح ي ط و ن)	بشيء (ب ش ي ع)	من (م ن)	علمه (ع ل م ه)		
2	0	2	4	2	2	3		
الا (ال ا)	بما (ب م ا)	شاء (ش ا)	وسع (و س ع)	كرسيه (ك ر س ي ه)	السموت (ال س م و ت)	و (و)		
3	3	1	1	4	4	0		
الأرض (ال ا ر ض)	و (و)	لا (ل ا)	ينوده (ي و د ه)	حفظهما (ح ف ظ ه م ا)	و (و)	هو (ه و)	العلي (ال ع ل ي)	
4	0	2	2	4	0	1	4	
العظيم (ال ع ظ ي م)								
4								

Numri gjigant që rezulton nga ky rregullim është:

**441042204044113332242032053234321312412041222203224413324.**

Është e mahnitshme, se si ky numër është shumëfish i numrit 7.

**441042204044113332242032053234321312412041222203224413324 = 63006029149159047463147436176331616058863031743317773332 x 7**

Ky rezultat perfekt vërteton përfundimisht që shkronjat e Besmeles në vete përmbajnë një sekret preciz matematikor, sekret ky që është deshifruar në shumë ajete Kur'anore, dhe së fundi edhe tek Ajetul Kursi, ajeti më i madh kur'anor.

Gjithashtu duhet të kemi parasysh se kemi shkruar ajete të ndryshme të Kur'anit saktësisht siç janë të shkruara në Kur'an, që

është absolutisht kritike në studimin tonë me mrekullitë numerike. Për shembull, fjala (السموت) (qiejt) - që gjendet në Ajetul-Kursi, si dhe në ajetet tjera - është shkruar në formë ndryshe nga ajo që shënohet në gjuhën e rregullt Arabe. Në Arabishten kur'anore, është shkruar (السموت), që përmban 4 shkronja të Besmeles. Po të ishte shkruar në Arabishten normale, ajo do të shkruhej (السموات), çka do të thotë se do t'i përmbante 6 shkronja të Besmeles. Po ta kishim këtë rast, rregullimi numerik që kemi fituar më lartë do të ishte shkatërruar plotësisht, sepse do të arrinim me një numër që nuk do të ishte shumëfish i numrit 7.

## Rrjeti i numrave

Ishim dëshmitarë se si mrekullia e shkronjave të Besmeles nuk është e kufizuara vetëm në shkronjat dhe fjalët e saj në vete. Mrekullia, gjithashtu ekziston në lidhjen mes Besmeles dhe ajeteve tjera Kur'anore. Këto lidhje nga vargu i ndryshëm dhe kompleksi i numrave zë fill në bukurinë e mrekullisë numerike të Kur'anit të Shenjtë.

Duke studiuar lidhshmërinë e Besmeles me të gjitha ajetet e Kur'anit, është diçka që kërkon një studim të thellë, mirëpo për tani, duket e mjaftueshme që të merren vetëm dy shembuj për studim, njërin nga kaptina e parë e Kur'anit dhe tjetri nga kaptina e fundit të Kur'anit të Shenjtë.

1. Kaptina e parë fillon me thënien e Allahut të Plotfuqishëm:

***“Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirë Bërësit! Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve!”*** (Al-Fatiha, 1:1-2).

2. Kaptina e fundit fillon me:

***“Thuaj: “Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve!”*** (En-Nas, 114:1).

Siç kemi potencuar më parë, Besmeleja në kaptinën e fundit të Kur'anit nuk është pjesë e ajeteve të saj; ajo vetëm gjendet në fillim të kaptinës. Dhe në të njëjtën mënyrë, në të gjitha kaptinat tjera të Kur'anit<sup>9</sup> gjendet në fillim, duke mos u konsideruar kështu pjesë e ajeteve. Përrjashtim të vetëm bënë Besmeleja që gjendet në suren El-Fatiha, i cili është ajeti i parë i Kur'anit.

Duke pasur parasysh se çdo fjalë në ajetet e mëparshme përmbante një mrekulli, tani do të koncentrohemi në veçanti vetëm në fjalën e parë dhe të fundit të çdo ajeti. Arsyeja për këtë është që lexuesit tanë të mos mendojnë se zgjedhjet e fjalëve tona janë bërë rastësisht, por në fakt sistematikisht. Ja pse ne zgjedhim pikërisht kapitullin e parë dhe të fundit, ajetin e parë dhe të fundit, dhe kështu me radhë.

Siç është cekur shumë herë më parë, ajeti i parë në Suren El-Fatiha është Besmeleja, dhe fjalët e para të saja janë (بِسْمِ), e që janë përsëritur 22 herë në Kur'an. Fjala e fundit në Besmele është (الرَّحِيمِ), e që është përsëritur 115 herë.

Ajeti i dytë në suren El-Fatiha është (الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ), fjala e parë e së cilës është (الْحَمْدُ). Kjo fjalë është përsëritur në Kur'an 38 herë, dhe fjala e fundit (الْعَالَمِينَ), përsëritet 73 herë<sup>10</sup>.

Dhe tash, le të jemi dëshmitar të një rrjeti mahnitës mes lidhjeve numerike të këtyre katër numrave (73 - 38 - 115 - 22) që gjithnjë gjeneron plotpjesëtimin me numrin 7.

## Fakti 1

Fjalët e para dhe të fundit të ajetit të Besmeles, (بِسْمِ - الْعَالَمِينَ), përsëriten 22 herë dhe 115 herë, përkatësisht. Duke kombinuar këta dy numra arrijmë tek numri 11522, plotpjesëtimin e parë me numrin 7:

$$11522 = 1646 \times 7$$

<sup>9</sup> Me përjashtim të sures Et-Tevbe, në të cilën nuk ka fare Besmele.

<sup>10</sup> Muhammed Fuad Abdul Baki, ed., *El-Mu'xhem-el-Mufehres Li-Elfadhil-Kuranil-Kerim* (Shabb Press, 1945).

Shënim: këtë shembull kemi parë më herët në këtë kaptinë, por ai njëkohësisht është edhe në këtë pjesë.

## Fakti 2

Më pas, numrat 38 dhe 73 paraqesin, fjalën e parë dhe të fundit në ajetin e dytë të sures El-Fatiha, përkatësisht, pra (الحمد - العلمين). Kjo formon numrin 7338, dhe nëse marrim këtë numër në drejtim të kundërt kemi 8337, që është shumëfish i 7:

$$8337 = 1191 \times 7$$

Tash do t'i përgjigjemi pyetjes eventuale se pse e kthyem mbrapa numrin 7338, dhe pse i kthejmë në drejtim të kundërt numrat tek të cilët arrijmë. Arsyeja qëndron në faktin se, shumë ajete kur'anore kanë kuptime edhe nga ana e kundërt.

Duke thënë këtë, në ajetin e Besmeles, (Në Emër të All-llahut, Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit), gjejmë atributin e mëshirës; mëshira e Zotit. Dhe mëshira është një atribut që gjithmonë qëndron pranë Emrit të Zotit. Me fjalë të tjera, mëshira është nga Krijuesi për krijesat e Tij.

Në anën tjetër, ajeti i dytë i sures El-Fatiha është (Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve!) një ajet që përmban atributet e lartësimit. Dhe lartësimi, sikundër mëshira, është bërë nga krijesa për Krijuesin. Me fjalë të tjera, ne jemi ato krijesa që madhërojmë Zotin për bekimet dhe mëshirën e pakufishme që është mbi ne.

Për këtë arsye, përshtatje kemi vetëm atëherë kur rregullimet numerike që theksojnë këto ajete paraqesin një natyrë të kundërt; një që në mënyrë perfekt plotëson interpretimet e tyre të sakta.

## Përmbledhim këtë rezultat të rëndësishëm:

الحمد لله رب العالمين	بسم الله الرحمن الرحيم
73 ← 38	115 → 22
Lexo nga e djathta në të majtë	Lexo nga e majta në të djathtë

### Fakti 3

Për këtë arsye këtë seksion të këtij libri e kemi quajtur "Rrjeti i numrave". Katër numrat në këtë rrjetë (73 - 38 - 115 - 22) gjithashtu janë të ndërlidhur në atë mënyrë që nuk ndalen së rreshtuari të na impresionojë në atë se sa herë këta katër numra japin<sup>11</sup> shumëfish të numrit 7.

Tani, marrim numrat që i përkasin fjalës së parë të ajetit të parë, dhe fjalës së parë të ajetit të dytë:

الحمد	بسم
38	22

Numri që përcakton përsëritjen e këtyre dy fjalëve në Kur'anin e Shenjtë është 3822: shumëfish i numrit 7.

$$3822 = 546 \times 7$$

Kemi arritur në përfundimit se fjala e parë e të dy ajeteve është e ndërlidhur me numrin 7.

### Fakti 4

Tani, marrim numrat që kanë të bëjnë me fjalën e fundit të ajetit të parë dhe fjalën e fundit të ajetit të dytë:

العلمين	الرحيم
73	115

Numri që përcakton përsëritjen e këtyre dy fjalëve në Kur'an është 73115, një shumëfish i 7-it:

<sup>11</sup> Vërejmë se edhe më tej jemi tek shembulli 1, pra i pari i dy ajeteve të kaptinës së parë të Kur'anit. Shembulli 2, që ka të bëjë me kaptinën e fundit të Kur'anit, në vete përmban një rrjet të vetin të tërë!



$$73115 = 10445 \times 7$$

Ne më tej kemi treguar se fjala e fundit e të dy ajeteve ka lidhshmëri sa i përket numrit 7.

### Fakti 5

Numrat të cilat ndërlidhen me fjalën e parë të ajetit të parë dhe fjalën e fundit të ajetit të dytë na japin:

العلمين	بسم
73	22

7322 gjithashtu është shumëfish i 7-it:

$$7322 = 1046 \times 7$$

### Fakti 6

Për dallim nga Fakti 5, do të konsiderojmë fjalën e fundit të ajetit të parë dhe fjalën e parë të ajetit të dytë:

الرحيم	الحمد
115	38

Numri që fitojmë është gjithashtu shumëfish i 7-it.

$$38115 = 5445 \times 7$$

Ishim dëshmitar të gjashtë fakteve të ndërlidhura ngushtë e që përkojnë me dy ajetet e para të sures El-Fatiha, dhe që të gjitha paraqesin shumëfish të numrit 7. Por mbase konkludimi më i rëndësishëm nga të gjithë është se këta numra vështirë se mund të lënë hapësirë për ndonjë koincidençë.

Koincidenca thjeshtë nuk mund të paraqitet kaq shpesh. Megjithatë, vërtetojmë dhe pranojmë që njerëzit mund të kenë dyshimet e tyre, e të cilat ne do t'i aplikojmë të njëjtën logjikë në

kaptinën e fundit të Kur'anit, për të parë se si rregullimet e njëjta mbajnë të njëjtën bukuri – vazhdimësi e shumëfishit të numrit 7.

### Fakti 7

Pasi ishim dëshmitar të një rregullimi shumë mahnitës mes Besmeles dhe ajeteve tjera që përcjellin atë në kaptinën e parë të Kur'anit të Shenjtë, shtrojmë pyetjen: a ruhen ato lidhje kur shqyrtojmë Besmelen dhe kaptinën e fundit të Kur'anit?

Kaptina e fundit e Kur'anit është surja En-Nas, dhe ajeti i parë në këtë sure është:

*“Thuaj: "Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve!”*

Fjala e parë në këtë ajet, (قل), në Kur'an është shkruar 332 herë. Fjala e fundit, (الناس) është përsëritur 241 herë.

Dhe tash, do t'i rregullojmë të dy numrat së bashku:

الناس	قل
241	332

Rezultati është 241332, një shumëfish i numrit 7:

$$241332 = 34476 \times 7$$

### Fakti 8

Tash, do shqyrtojmë numrat (241 - 332 - 115 - 22), që paraqesin përsëritjen në Kur'an të fjalës së parë dhe të fundit të Besmeles dhe ajetit të parë të sures El-Nas.

الناس	قل	الرحيم	بسم
241	332	115	22

Le të hulumtojmë tani këtë rrjet të numrave në të njëjtën mënyrë siç hulumtuam dy ajetet e para të sures El-Fatiha.

Fillimisht, duke marrë numrat e fjalës së parë të ajetit të parë, dhe fjalës së parë të ajetit të dytë, marrim:

قل	بسم
332	22

Numri që përcakton përsëritjen e këtyre dy fjalëve në Kur'an është 33222, i plotpjestueshëm me numrin 7.

$$33222 = 4746 \times 7$$

### Fakti 9

Tash do shfrytëzojmë numrat e fjalës së fundit të ajetit të parë, dhe fjalës së fundit të ajetit të dytë:

الناس	الرحيم
241	115

Rezultati është 241115, gjithashtu i plotpjesëtueshëm me 7:

$$241115 = 34445 \times 7$$

### Fakti 10

Numrat që ndërlidhin fjalën e parë të ajetit të parë, dhe fjalën e fundit të ajetit të dytë janë si vijon:

الناس	بسم
241	22

Numri 24122 është i plotpjesëtueshëm me 7:

$$24122 = 3446 \times 7$$

**Fakti 11**

Më në fund, do marrim numrat e fjalës së fundit të ajetit të parë, dhe fjalën e parë të ajetit të dytë:

قل	الرحيم
332	115

Numri 332115 gjithashtu është i plotpjesëtueshëm me 7.

$$332115 = 47445 \times 7$$

Siç kuptuam, shumëfishët e numrit 7, të ilustruara më lartë, përfshijnë vetëm gjashtë fjalë të ndryshme, megjithatë, këto fjalë prodhojnë një rrjetë interaktiv të ndërlikohjes, e që është shumë e vështirë të interpretohet si koincidençë. Kjo vetëm se na bënë të pyesim: a thua vallë çfarë preciziteti të lartë mund të presim të gjejmë nëse do studiojmë të gjitha fjalët e Kur'anit, më shumë se 70,000?

### **Besmeleja reflekton më shumë në bukurinë e saj - ajeti i përsosshmërisë**

Tashmë kemi thënë se Besmeleja përbëhet nga dhjetë shkronja të ndryshme Arabe:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ (ب س م ا ل ر ح ن ي)

Siç kemi parë, pjesë e bukurisë së ajetit të Besmeles është se shkronjat e tij gjenden në shumë fjalë të Kur'anit në mënyrë konsistence me numrin 7.

Tani do të shikojmë një ajet të veçantë, i cili përfaqëson pikë kthese në dallimet në mes të Islamit dhe besimeve të tjera, dhe thekson përsosmërinë e Zotit mbi deklaratimet se ai kishte fëmijë

ose se ishte i lindur. Ky është ajeti i tretë i kaptinës 112, surja El-Ihlas (kaptina: Singëriteti):

*“As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur”*

(El-Ihlas, 112:3).

### Ajeti i përsosmërisë

Ky ajet, ndonëse shumë i shkurt, bart në vete një mrekulli të pashtershme që lidhet me Besmelen. Është një nga ato ajetet që përforcojnë besimin thelbësor të muslimanëve se askush tjetër përveç All-llahut nuk meriton të adhurohet dhe se në fakt nuk ka zot tjetër përveç All-llahut të Madhëruar.

Disa shkronja të këtij ajeti, siç do të shohim së shpejti, janë të përsosura dhe rregulluara në atë mënyrë që kanë prodhuar një koleksion të bukur të shumëfishëve të numrit 7.

Mrekullia numerike që do të shohim është bazuar në shkronjat e secilës fjalë në Besmele: (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ). Pra shkronjat e secilës fjalë të Besmeles janë të radhitura përgjatë ajetit të tretë të sures El-Ihlas (لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ).

Duke marrë çdo fjalë të Besmeles, tani do t'i numërojmë shkronjat që kanë të përbashkët me çdo fjalë të Besmeles (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ).

1. Fjala e parë në Besmele është (بِسْمِ), dhe përmban tre shkronja:

(ب س م)
---------

Kjo është ndarja e shkronjave të ajetit 3 të Sures El-Ihlas:

(ل م)	(ي ل د)	(و)	(ل م)	(ي و ل د)
-------	---------	-----	-------	-----------

Tani, lehtë mund të numërojmë se çfarë përmban secila nga pesë fjalët e mësipërme, prej tre shkronjave të fjalës (بسم). Për shembull, fjala e parë, (لم), përmban një shkronjë të (بسم) pra (م) dhe për këtë i është shoqëruar numri 1. Fjala e dytë , (يلد), fjala e tretë , (و)<sup>14</sup> dhe fjala e pestë , (يولد) nuk kanë asnjë shkronjë të përbashkët me (بسم), prandaj të gjithave i është shoqëruar numri 0. Rregullimin e parë tek i cili kemi arritur është:

يولد	لم	و	يلد	لم
0	1	0	0	1

Numri 01001 është shumëfish i numrit 7:

$$01001 = 143 \times 7$$

2. Fjala e dytë e Besmeles është (الله) dhe përmban katër shkronja.

(الله)

Njëra nga shkronjat e mësipërme, përsëritet dy herë, dhe në fakt është vetëm një shkronjë e përbashkët me ndonjërin prej fjalëve të ajetit 3 të sures El-Ihlas: duke përdorur metodën e njëjtë që pasuam me fjalën e parë të Besmeles, merret rregullimi vijues:

يولد	لم	و	يلد	لم
1	1	0	1	1

Numri 110011 është shumëfish i numrit 7:

$$11011 = 1573 \times 7$$

3. Fjala e ardhshme në Besmele është (الرحمن) dhe përbëhet prej gjashtë shkronjave:

( ا ل ر ح م ن ) الرحمن

Kjo prodhon rregullimin në vijim:

يولد	لم	و	يلد	لم
1	2	0	1	2

Numri 12012 është shumëfish i 7:

$$12012 = 1716 \times 7$$

4. Fjala e fundit në Besmele (الرحيم), përbëhet nga gjashtë shkronja:

( ا ل ر ح ي م ) الرحيم

Rregullimi final është si vijon:

يولد	لم	و	يلد	لم
2	2	0	2	2

Numri 22022 është shumëfish i 7:

$$22022 = 3146 \times 7$$

A mundet rastësia të përsëritet katër herë radhazi në një mënyrë shumë të njëjtë?

Çfarëdo që të jetë përgjigjja, ne megjithatë do të vazhdojmë më tej me këtë ajet të mrekullueshëm, për të zbuluar më tepër shumëfish të 7.

Siç e kemi theksuar më parë, bukuria e mrekullisë numerike të Kur'anit është se nuk kufizohet në vetëm një ajet, por gjithashtu e kaplon lidhjen e atij ajeti me të tjerët në Kur'an; në këtë mënyrë paraqet një rrjetë komplekse të lidhjeve numerike.

Dhe për të zhdukur çdo mundësi të rastësisë, ne tani do të marrim çdo fjalë të Besmeles dhe nën të do të shkruajmë katër rezultatet e gjetura më sipër; pra numrat e gjetur si rezultat i pjesëtimit të çdo rregullimi me 7. Rezultatet janë si vijojnë:

- Rezultati i pjesëtimit të rregullimit të shkronjave të (بِسْمِ) përgjatë ajetit 3 të Sures El-Ihlas me 7 na jep 0143.
- Rezultati i pjesëtimit të rregullimit të shkronjave të fjalës së dytë të Besmeles, (الرَّحْمَنِ) është 1573.
- Rezultati i pjesëtimit të rregullimit të shkronjave të (الرَّحْمَنِ) është 1716.
- Rezultati i pjesëtimit të rregullimit të shkronjave të (الرَّحِيمِ) është 3146.

Tani, me rregullimin e katër numrave në një numër të vetëm, arrijmë në:

3146	1716	1573	0143
------	------	------	------

16 shifrat e numrit 3146171615730143 paraqesin shumëfish të 7.

$3146171615730143 = 449453087961449 \times 7$
---

### Përsëritja e fjalëve të Besmeles – shifrat magjepsë

Çdo e katërta fjalë e Besmeles qëllimisht është përsëritur me numër të saktë në Kur'anin e Shenjtë. Saktësia në numrin e këtyre



përsëritjeve është e tillë që vështirë të imagjinohet që ndokush tjetër përveç All-llahut të Plotfuqishëm të mund ta ketë ruajtur atë. Kjo thjesht, sepse rregullimet që do t'i shohim, që vijnë prej përdorimit të katër numrave, nuk janë më pak befasuese.

Besmeleja, siç e dimë mirë, është:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Fjala e parë është (بِسْمِ), dhe është cituar 22 herë në Kur'an, fjala e dytë, (اللَّهُ), është përsëritur 2699 herë, fjala e tretë, (الرَّحْمَنِ), është përsëritur 57 herë dhe e fundit, (الرَّحِيمِ), është përsëritur 115 herë . Çka është me të vërtetë e pabesueshme, është se tani ne do të gjejmë shumën e shifrave për secilin numër të ndarë, dhe pastaj i kombinojmë rezultatet në një numër të vetëm dhe do të shohim se si na jep shumëfish të numrit 7.

- Përsëritja e (بِسْمِ) është 22, dhe shuma e këtyre shifrave është  $2+2 = 4$ .
- Përsëritja e (اللَّهُ) është 2699, dhe shuma e këtyre shifrave është  $2+6+9+9 = 26$ .
- Përsëritja e (الرَّحْمَنِ) është 57, dhe shuma e këtyre shifrave është  $5+7 = 12$ .
- Përsëritja e (الرَّحِيمِ) është 115, dhe shuma e këtyre shifrave është  $1+1+5 = 7$ .

Le të kombinojmë katër numrat e fituar më sipër në rregullimin vijues:

7 | 12 | 26 | 4

Numri 712264 është dy herë shumëfish i numrit 7:

$712264 = 14536 \times 7 \times 7$

Çuditërisht, leximi i këtij numri prej drejtimit të kundërt jo vetëm që na jep shumëfish të numrit 7, por dy herë shumëfish të 7:

$$462217 = 9433 \times 7 \times 7$$

Dhe nëse këta dy shembuj nuk janë të mjaftueshëm, edhe një më shumë nuk do të bënte keq. Numrat 4, 26,12 dhe 7 janë shuma e katër numrave që ne i kemi llogaritur. Nëse i marrim vetëm këta numra (që është vetëm shuma e këtyre numrave!), dhe e llogarisim shumën e tyre, gjejmë:

$$4 + 26 + 12 + 7 = 49$$

Dhe numri 49, të dashur lexues, nuk është asgjë tjetër pos  $7 \times 7$ . Thelbi i këtyre rezultateve është i mrekullueshëm dhe me të vërtetë na bënë të mendojmë se vallë a ekziston ndonjë njeri që të ketë aftësi të shkruaj një libër ku fjalitë e parë përmban një strukturë të fshehur të rregullimeve numerike që rrjedhin përgjatë saj.

### **\Emri i Zotit në ajetin e parë dhe të fundit të cilat përmendin (الله)**

Emri kryesor i Zotit të Gjithëfuqishëm është (الله), apo (Allah). Është përsëritur shumë herë në Kur'an: më saktësisht 2699 herë. Duke studiuar të gjitha këto përsëritje do merrte shumë kohë, dhe për momentin, do të koncentrohemi vetëm në përmendjen e parë dhe të fundit të Emrit të Tij në Kur'an.

Hera e parë kur përmendet emri All-llah është ajeti i parë i Kur'anit - Besmeleja, (بِسْمِ اللَّهِ). Në këtë ajet, emri i Zotit përcillet edhe me dy emra tjerë të Tij, (الرحمن) (i Gjithëmëshirshmi) dhe (الرحيم) (Mëshirëploti).

Përmendja e fundit e emrit All-llah në Kur'an ndodhet në ajetin e dytë të Sures El-Ihlas:

***“All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë”***

(El-Ihlas 112:2).

Këtu, emri i Zotit është pasuar edhe me një ndër emrat e Tij, (الصمد) (i Përjetshmi, Absoluti). Tash do të koncentrohemi në seritë vijuese të rregullimeve numerike.

### **Numri i kaptinave**

Surja El-Fatiha është kaptina e cila përmend emrin All-llah për herën e parë dhe surja El-Ihlas është kaptina e cila e përmend për herë të fundit. Duke numëruar numrin e kaptinave nga surja El-Fatiha deri te surja El-Ihlas, kemi 112 kaptina, dhe ky numër paraqet shumëfish të numrit 7.

$$112 = 16 \times 7$$

### **Numri i ajeteve**

Njësoj, do të fillojmë numërimin e ajeteve nga ajeti i parë në të cilin përmendet<sup>12</sup> emri All-llah, deri te ajeti final i cili gjithashtu e përmend këtë emër. Vërejmë së numri i ajeteve është saktësisht 6223<sup>13</sup>, një numër që gjithashtu paraqet shumëfish të *dyfishtë* të numrit 7:

---

<sup>12</sup> Siç e dimë është ajeti i parë i Kur'anit, Besmeleja!

<sup>13</sup> Ndonëse mund të marr kohë, çdokush këtë mund ta verifikojë edhe vet. Disa publikime të Kur'anit përmbajnë indeksin i cili cek numrin e ajeteve në çdo kaptinë, dhe e bënë këtë punë më të lehtë.

$$6223 = 127 \times 7 \times 7$$

### Numri i shkronjave

Ajeti i parë që është përmendur (الله) në Kur'an përbëhet prej **19 shkronjave**:

ب س م ا ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م

Ajeti i fundit përbëhet prej **9 shkronjave**:

ا ل ل ه ا ل ا ل ص م د

Duke i mbledhur këta numra së bashku na jep një tjetër shumëfish të 7:

$$19 + 9 = 28$$

$$28 = 4 \times 7$$

### Rregullimi në shkronjat e Emrit All-llah (الله)

Siç është përmendur më herët në këtë pjesë, fjala (الله) përbëhet nga 3 shkronja të *ndryshme*, domethënë “Elif” (أ), “Lām” (ل), dhe “Hā” (ه). Këto tre shkronja në ajetin e parë që përmend emrin All-llah (الله) janë gjetur 8 herë:

ب س م ا ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م

ا ل ل ه ا ل ا ل

Këto shkronja, në ajetin e fundit që përmend (الله) janë gjetur 6 herë:

ال ل ه ا ل ص م د
ال ل ه ا ل

Duke i mbledhur këta dy numra, arrijmë në shumëfish të 7:

$8 + 6 = 14$
$14 = 2 \times 7$

Çuditërisht, numri i shkronjave në këto dy ajete është 28, dhe 14 prej tyre (pra gjysma) janë ato tri shkronja që përbëjnë emrin e All-llahut! Kjo mund të na kthejë mendjen tonë pakëz më herët, kur kemi vërejtur që shkronjat e gjuhës Arabe, gjuhës së Kur'anit, janë 28, gjysma e të cilave janë gjetur në Kur'an në “frazë të veçanta (shkronjat në fillim të disa sureve)”.

Para se të numërojmë, pyesim: Kush është ai i cili ka mundur të bëjë shumëfish të 7-it numrin e kaptinave, nga e para që e përmend emrin All-llah (الله) deri tek e fundit? Ngjashëm, Kush e bëri shumëfish të 7-it numrin e ajeteve, nga ajeti i parë që citon emrin (الله) deri tek i fundit? Kush siguroi që numri i shkronjave në mes të këtyre dy ajeteve të jetë shumëfish i 7-it, dhe që prezenca e shkronjave të emrit (الله) në këto dy ajete gjithashtu të krijojë shumëfish të 7-it. A nuk është Bartësi i atij emri? A nuk është Vet All-llahu i Plotfuqishëm? Është interesante të reflektojmë për këtë, por kemi për të përshkruar edhe disa rregullime.

### **Shkronjat e emrit Er-Rrahman (الرحمن)**

Shkronjat e emrit Er-Rrahman (الرحمن), një tjetër emër i All-llahut të Plotfuqishëm, janë “Elif” (أ), “Lām” (ل), “Rā” (ر), “Ḥā” (ح), “Mīm” (م), dhe “Nūn” (ن). Këto shkronja janë gjetur 15 herë në ajetin e parë në të cilin emri All-llah (الله) është cituar:

ب س م ا ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م
م ا ل ل ا ل ر ح م ن ا ل ر ح م

Në ajetin e fundit, këto shkronja janë gjetur 6 herë.

ا ل ل ه ا ل ص م د
ا ل ل ه ا ل

Shuma e këtyre dy numrave është sërish shumëfish i 7:

$15 + 6 = 21$
$21 = 3 \times 7$

### Shkronjat e emrit Er-Rrahim (الرحيم)

Rezultati i mëparshëm përsëritet vetvetiu me emrin Er-Rrahim (الرحيم). Ky emër i All-llahut përbëhet prej shkronjave “Elif” (أ), “Lām” (ل), “Rā” (ر), “Ḥā” (ح), “Mīm” (م), dhe “Yā” (ي). Këto shkronja gjenden 15 herë në ajetin që së pari e përmend emrin All-llah (الله) dhe 6 herë në ajetin që e përmend atë në fund:

ب س م ا ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م
م ا ل ل ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م
ا ل ل ه ا ل ص م د
ا ل ل ه ا ل

### Numrat e kaptinave dhe ajeteve

Rregullat e mëposhtme përfshijnë numrat e kaptinave dhe numrat e ajeteve të dy ajeteve tona përkatëse:

Numri i ajeteve	Numri i kaptinave	Numri i ajeteve	Numri i kaptinave
2	112	1	1

Numri 211211 është shumëfish i 7:

$$211211 = 30173 \times 7$$

### Përsëritja e fjalëve

Le të shkruajmë thjeshtë fjalët e çdonjërës prej dy ajeteve njëri pas tjetrit, së bashku me numrin se sa herë çdo fjale është përsëritur në Kur'anin e Shenjtë:

الصمد	الله	الرحيم	الرحمن	الله	بسم
1	2699	115	57	2699	22

Ky numër i madh, 1269911557269922, është shumëfish i 7:

$$1269911557269922 = 181415936752846 \times 7$$

Jo vetëm kjo, por duke mbledhur merret një numër i cili sërish është shumëfish i 7:

$$1 + 2699 + 115 + 57 + 2699 + 22 = 5593$$

$$5593 = 799 \times 7$$

### Rregullimi i përsëritjeve të shkronjave dhe fjalëve

Ajeti i parë i cili e përmend emrin e All-llahut është Besmeleja, që është (بسم الله الرحمن الرحيم). Ajo përmban tre emra të All-llahut: (الرحمن) , (الله) dhe (الرحيم). Për secilin nga këta emra, le t'i

identifikojnë numrat e shkronjave që ata përbëjnë, dhe numrin se sa herë janë përsëritur ata në Kur'an.

1. Emri (الله) përbëhet prej 4 shkronjave, dhe është përsëritur 2699 herë.

2. Emri (الرحمن) përbëhet prej 6 shkronjave, dhe është përsëritur 57 herë.

3. Emri (الرحيم) përbëhet prej 6 shkronjave, dhe është përsëritur 115 herë.

Me rregullimin e këtyre numrave, arrijmë në rezultatin vijues:

Përsëritja	Shkronjat	Përsëritja	Shkronjat	Përsëritja	Shkronjat
115	6	57	6	2699	4

Numri 115657626994, i cili paraqet shkronjat e atyre emrave në ajetin e parë dhe përsëritjen e përgjithshme të secilit emër në Kur'an, është shumëfish i 7:

$$115657626994 = 16522518142 \times 7$$

Përputhje shumë e ngjashme përsëritet kur konsiderojmë ajetin e fundit që përmend emrin e All-llahut, (الله), kur All-llahu i Plotfuqishëm thotë: (ال ل ه ا ل ص م د). Ky ajet përbëhet prej vetëm dy fjalëve, të cilat janë emra të All-llahut:

1. Emri (الله) përbëhet prej 4 shkronjave, dhe është përsëritur 2699 herë.

2. Emri (الصد) përbëhet prej 5 shkronjave, dhe është përsëritur 1 herë.

Përsëritja	Shkronjat	Përsëritja	Shkronjat
1	5	2699	4

Numri 1526994 është shumëfish i numrit 7:



$$1526994 = 218142 \times 7$$

Këto rezultate tregojnë se All-llahu ka organizuar përsëritjen e emrit e Tij dhe shkronjat e emrit të Tij, në mënyrë tepër precize.

### Rregullimi i shkëlqyeshëm i shkronjave të alfabetit

Tani do të shikojmë në një varg të lartë të ndërlidhjes (dhe potencialisht të ndërlikuar!) të rregullave që zë vendin në mes të shkronjave të dy ajeteve.

Kemi përfunduar se ajeti i parë që përmend emrat e All-llahut në të vërtetë bartë jo vetëm një, por tre emra të Tij: (الله), (الرحمن) dhe (الرحيم). Këto tre fjalë përbëhen prej 16 shkronjave në tërësi, por gjysma e tyre janë përsëritur më tepër se një herë. Me fjalë të tjera, duke mos i marrë parasysht përsëritjet, janë 8 shkronja të ndryshme të alfabetit në mes të këtyre emrave:

ال ل ه ا ل ر ح م ن ا ل ر ح ي م

Këto janë 8 shkronjat:

ال ه ر ح م ن ي

Shuma e shkronjave të alfabetit në mes dy ajeteve është shumëfish i 7:

$$8 + 6 = 14$$

$$14 = 2 \times 7$$

Kjo është pika e fillimit për të ndjekur një varg të shumëfishëve të 7, por vërejmë se mund t'i krahasojmë këto rezultate me të

mëparshmet kur thuhet se shkronjat e emrit të All-llahut, (الله), janë gjetur 14 herë në këto dy ajete gjer tani.

Tani, ne do t'i studiojmë shkronjat e emrave të All-llahut në ajetin e parë dhe të fundit në më shumë detaje, me shpresën për të nxjerrë më shumë shumëfish të 7. Në këta pesë emra - All-llah – Er-Rrahman – Er-Rrahim – All-llah – Es-Samed – tre të parët janë vendosur në atë mënyrë që japin shumëfish të 7, dhe ngjashëm, dy të fundit janë vendosur për të rezultuar në shumëfish të 7. Natyrisht, pasi kemi të bëjmë me ajetin e parë dhe të fundit që përmend (الله), ky emër (الله) vetvetiu është gjetur në të dy ajetet dhe është përsëritur dy herë.

### Rregullimi i shkronjave (الله – الرحمن – الرحيم)

Sa për të përsëritur, dimë që këta tre emra të All-llahut: (الرحمن), (الله) dhe (الرحيم), përmbajnë 8 shkronja të ndryshme të alfabetit, dhe janë gjetur në ajetin e parë që përmend emrin e All-llahut në Kur'an. Këto 8 shkronja janë:

ا ل ه ر ح م ن ي

Tani do të shqyrtojmë këto 8 shkronja në pesë emrat e All-llahut: All-llah, Er-Rrahman, Er-Rrahim, All-llah dhe Es-Samed. Për t'i thjeshtuar gjërat për lexuesit jo Arab, për lehtësim të krahasimit, do t'i zbërthejmë shkronjat e çdo fjale:

الصمد	الله	الرحيم	الرحمن	الله
( ا ل ص م د )	( ا ل ل ه )	( ا ل ر ح ي م )	( ا ل ر ح م ن )	( ا ل ل ه )
3	4	6	6	4

Rezultati është 34664, dhe është shumëfish i numrit 7:

$$34664 = 4952 \times 7$$

### Rregullimi i shkronjave të emrave All-llah dhe Es-Samed

Në mënyrë që të minimizojmë çdo mundësi të rastësisë, ne do të bëjmë të njëjtin eksperiment me dy emrat e mbetur, (الله) dhe (الصمد), të cilat janë gjetur në ajetet e fundit që përmendin emrat e All-llahut. Këto përmbajnë 6 shkronja të ndryshme:

ا	ل	ه	ص	م	د
---	---	---	---	---	---

Duke kërkuar këto shkronja në pesë emrat e All-llahut, gjejmë sa vijon:

الصمد	الله	الرحيم	الرحمن	الله
(ا ل ص م د)	(ا ل ه)	(ا ل ر ح ي م)	(ا ل ر ح م ن)	(ا ل ه)
5	4	3	3	4

Në të vërtetë, numri 54334 është shumëfish i 7:

$$54334 = 7762 \times 7$$

### Rregullimi i shkronjave të emrave Er-Rrahman dhe Er-Rrahim

Edhe nëse konsiderojmë (الرحمن) dhe (الرحيم) prej ajetit të parë (që është, pa emrin kryesor të All-llahut (الله), do të ruhet rezultati i njëjtë. Këta dy emra përmbajnë 7 shkronja të ndryshme:

ا	ل	ر	ح	م	ن	ي
---	---	---	---	---	---	---

Sërish, në kërkim të këtyre shkronjave në secilin prej 5 emrave të All-llahut, gjejmë:

الصمد (ال ص م د)	الله (ال ل ه)	الرحيم (ال ر ح ي م)	الرحمن (ال ر ح م ن)	الله (ال ل ه)
3	3	6	6	3

Mrekulli, numri i cili paraqet përsëritjen e shkronjave të dy emrave (الرحمن) dhe (الرحيم) në grupin e emrave më sipër është dy herë shumëfish i 7:

$$33663 = 687 \times 7 \times 7$$

### Rregullimi i shkronjave të Es-Samed (الصمد)

Në të njëjtën mënyrë, ne do të marrim emrin (الصمد) prej ajetit të fundit, pa emrin (الله), dhe shihni se si 5 shkronjat janë rregulluar në secilën prej pesë emrave të All-llahut në të dy ajetet që jemi duke i studiuar. Këto janë 5 shkronjat të (الصمد).

د	م	ص	ل	ا
---	---	---	---	---

Këto shkronja janë gjetur si të tilla në pesë emrat e All-llahut:

الصمد (ال ص م د)	الله (ال ل ه)	الرحيم (ال ر ح ي م)	الرحمن (ال ر ح م ن)	الله (ال ل ه)
5	3	3	3	3

Numri 53333 është shumëfish i numrit 7:

$$53333 = 7619 \times 7$$

Ne kemi parë se si këto forma të rregullimit plotpjesëtohen me 7 në raport me pesë emrat e All-llahut: All-llah, Er-Rrahman, Er-Rrahim, All-llah dhe Es-Samed.

Megjithatë, është edhe një tjetër varg i mrekullueshëm i rregullimeve në raport me këta pesë emrat, siç do ta shohim në vijim.

### **Përsëritja e shkronjës ( Lam - ل ) në emrin (الله)**

Emri i All-llahut (الله) përbëhet prej 4 shkronjave; njëra nga këto shkronja, (ل), është përsëritur dy herë. Kjo do të thotë se ai përbëhet prej 3 shkronjave të ndryshme. Duke e thënë këtë, përveç emrave të cilat i kemi ekzaminuar, do të thotë pesë emrat: All-llah, Er-Rrahman, Er-Rrahim, All-llah dhe Es-Samed, (الله) është i vetmi emër i cili përmban një shkronjë të përsëritur. Pjesa tjetër (الرحيم), (الرحمن), dhe (الصمد), përbëhet tërësisht prej shkronjave të ndryshme.

Në qoftë se kryejmë të njëjtin shembull të cilën sapo e përfunduam; e që është, nëse i marrim shkronjat (الرحمن – الرحيم – الله), dhe shikojmë për prezencën e tyre në rregullimin e (الله – الرحمن – الرحيم – الله - الصمد), vetëm këtë herë duke mos i pasur parasysh shkronjat e përsëritura të (ل) në (الله), ne do të arrijmë në 4 rregullime të reja, dhe 4 shumëfish të tjerë të 7!

Ne do ta bëjmë këtë vetëm me shembullin e parë, (الله – الرحمن – الرحيم), pasi e njëjta logjikë mund të zbatohet në pjesën tjetër të mbetur.

Përsëri, (الله – الرحمن – الرحيم) përmban 8 shkronja të ndryshme:

ا	ل	ه	ر	ح	م	ن	ي
---	---	---	---	---	---	---	---

Duke i kërkuar këto 8 shkronja në pesë emrat e All-llahut ne kemi shqyrtuar, (الله – الرحمن – الرحيم – الله - الصمد), por me përjashtim të përsëritjes së (ل) në (الله), ne gjejmë:

الصد (ال ص م د)	الله (ال ل ه)	الرحيم (ال ر ح ي م)	الرحمن (ال ر ح م ن)	الله (ال ل ه)
3	3	6	6	3

Numri 3663 është dy herë shumëfish i 7:

$$33663 = 687 \times 7 \times 7$$

Çdokush që dëshiron të përpiqet për pjesën tjetër të rregullimit pa përsëritje të (ل) në (الله) në të do gjej se (الله الصد) jep numrin 53333, (الرحمن الرحيم) jep 32662, (الصد) jep 52332<sup>14</sup>, dhe se të gjitha janë shumëfish të 7.

Kjo paraqet përfundimin e studimit tonë të marrëdhënieve në mes të përmendjes së parë dhe të fundit të (الله) në Kur'an. Tani shohim më nga afër parën herë kur është përmendur emri i All-llahut të Plotfuqishëm.

### **Për herë të parë All-llah (الله) është përmendur në Kur'an**

Emri kryesor i All-llahut të Plotfuqishëm, siç kemi treguar, ekziston në ajetin e parë, (بسم الله الرحمن الرحيم). Tani do të tregojmë se si All-llahu i Plotfuqishëm e ka rregulluar vendndodhjen e këtij ajeti, numrin e shkronjave të tij, dhe përsëritjen e fjalëve në Kur'an në mënyrën më të përsosur në përputhje me numrin 7.

Kjo që u tha, Besmeleja është ajeti i parë në suren El-Fatiha, dhe prandaj i është shtuar numri 1. Numri i shkronjave të saj është 19, dhe përsëritja e katër shkronjave të saj në Kur'an është si vijon:

1. Fjala (بسم) është përsëritur 22 herë.
2. Fjala (الله) është përsëritur 2699 herë.
3. Fjala (الرحمن) është përsëritur 57 herë.

<sup>14</sup> Dy herë shumëfish i numrit 7.

4. Fjala (الرحيم) është përsëritur 115 herë.  
Shuma e këtyre përsëritjeve është:

$$22 + 2699 + 57 + 115 = 2893$$

Le t'i marrim parasysh rezultatet tona në rregullimin vijues:

Besmeleja		
Numri total i përsëritjeve	Numri i shkronjave	Numri i ajeteve
2893	19	1

Bukuria e numrit tek i cili kemi arritur 2893191, është se ai mund të plotpjesëtohet me 7 kur ne lexojmë nga të dy anët:

$$2893191 = 413313 \times 7$$

$$1913982 = 273426 \times 7$$

Ne do të përdorim logjikë të njëjtë me emrin e All-llahut (الله). Ai gjendet në ajetin e 1, e përbërë prej 4 shkronjave, dhe është përsëritur 2699 herë në Kur'an.

Emri (الله)		
Fjalët e përsëritura	Numri i shkronjave	Numri i ajeteve
2699	4	1

Mrekulli, numri 269941, i cili përfaqëson tre statistikat në lidhje me emrin e All-llahut të Plotfuqishëm në ajetin e parë të Kur'anit të Shenjtë, është shumëfish i numrit 7 jo dy herë, por tre herë:

$$269941 = 787 \times 7 \times 7 \times 7$$

I njëjti model gjendet në emrat e dytë të All-llahut në ajetin e parë (الرحمن):

Emri (الرحمن)		
Fjalët e përsëritura	Numri i shkronjave	Numri i ajeteve
57	6	1

Numri 5761 sërish është shumëfish i 7:

$$5761 = 823 \times 7$$

## El-Fatiha dhe El-Ihlas

Në këtë pikë, jemi shumë të vetëdijshëm se (الله) është përmendur së pari në suren El-Fatiha, kur All-llahu thotë: (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ), dhe së fundi në suren El-Ihlas, kur Ai thotë: (الله الصمد).  
Le t'i shkruajmë këta dy kapituj në tërësi:

### Surja El-Fatihah

﴿ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٢﴾ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿٣﴾ مَلِكِ ﴿٤﴾  
يَوْمِ الدِّينِ ﴿٥﴾ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٦﴾ أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٧﴾  
صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ﴿٨﴾ ﴾

1. Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirë Bërësit!
2. Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve!
3. Mëshiruesit, Mëshirë Bërësit!
4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit (përgjegjesisë-shpërblimit)!
5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë!



6. Udhëzона (përforcona) në rrugën e drejtë!
7. Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten! (El-Fatiha, 1-7).

### Surja El-Ihlas

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ﴿١﴾ اللَّهُ الصَّمَدُ ﴿٢﴾ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ﴿٣﴾ وَلَمْ يَكُن لَّهُ كُفُوًا أَحَدٌ ﴿٤﴾﴾



1. Thuaj: Ai, All-llahu është Një!
2. All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë.
3. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur.
4. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë. (El-Ihlas, 1-4).

### Relacioni në mes dy kaptinave

Për një gjë, fjala “El-Fatiha” vetë në Arabisht është (الْفَاتِحَة) dhe përbëhet prej 7 shkronjave, d.m.th. ( ا ل ف ا ت ح ه ). Fjala “El-Ihlas” (الإِخْلَاص) gjithashtu përbëhet prej 7 shkronjave: ( ا ل ا خ ل ا ا ص ). Ky është vetëm një vëzhgim i vogël.

Për më tepër, surja El-Fatiha është kaptina 1 dhe ka 7 ajete. Surja El-Ihlas është kaptina 112 dhe ka 4 ajete. Këta numra mund të rregullohen si vijon:

Surja El-Ikhlās		Surja El-Fatihah	
Numri i ajeteve	Numri i kaptinave	Numri i ajeteve	Numri i kaptinave
4	112	7	1

Numri 412271 është shumëfish i 7:

$$412271 = 58753 \times 7$$

Gjithashtu, të mos e harrojmë rëndësinë e dy kaptinave në Kur'anin e Shenjtë: surja El-Fatiha, kaptina më e rëndësishme, e cila është referencë për ne si “Nëna e Librit” dhe “Shtatëshja që përsëritet”, dhe nga mësimet e të Dërguarit Muhammedit (a.s.), leximi i Sures El-Ihlas është i barabartë me të lexuarit e një të tretës së Kur'anit.

### Relacioni në mes dy ajeteve

Ajeti (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ) është gjetur në kaptinën 1, ajeti 1, gjersa (اللَّهُ الصَّمَدُ) është gjetur në kaptinën 112, ajeti 2:

Numri i ajeteve	Numri i kaptinave	Numri i ajeteve	Numri i kaptinave
2	112	1	1

Ne edhe më parë kemi ardhur tek ky rregullim, megjithatë, nuk e kemi vërejtur që numri 211211 është i plotpjesëtueshëm me 7 nga të dy drejtimet, dhe leximi i tij në të kundërtën aktualisht na jep dy herë shumëfish të numrit 7:

$$211211 = 30173 \times 7$$

$$112112 = 2288 \times 7 \times 7$$

### Shënimi i shkurtër

Të dashur lexues, vini re se emrat e All-llahut që janë gjetur në këto dy ajete kanë qenë të gjithë të përsëritur në numër tek: (اللَّهُ)

2699 herë, (الرحمن) 57 herë,(الرحيم) 115 herë dhe (الصمد) vetëm 1 herë. Të gjithë këta numra tek janë në të vërtetë “Vitër” (tek), dhe sikurse tha I Dërguari (a.s.) në një thënie të tij:

**“All-llahu ka nëntëdhjetë e nëntë Emra, pra, njëqind pa një, andaj kushdo që i përfshin të gjithë ata dhe vepron në përputhje me të, do të hyjë në Xhenet, ndërsa All-llahu është Vitër (Një dhe I Vetëm) dhe e donë “Vitrin”( pra, tekun).<sup>15</sup>”**

### **Rregullimi i Besmeles në Kur'an**

Ne më në fund kemi arritur në rregullimin numerik më mbresëlënës deri më tani.

Kur'ani përmban saktësisht 114 Besmele, të cilat janë të rregulluara në një mënyrë të veçantë përgjatë ajeteve të Kur'anit. Në vështrim të parë, asgjë unike e veçantë për këtë Besmele nuk është e dukshme, së paku në kuptimin numerik.

Megjithatë, fakti më i rëndësishëm që të gjitha këto Besmele, me përjashtim të njërës, paraqiten në fillim të çdo fillimi të ajetit, në të vërtetë kërkon një rregullim numerik të mahnitshëm, që e bënë një përfundim shumë të përshtatshëm për këtë pjesë të librit.

Kemi thënë që Surja Et-Tevbe, kaptina 9, është kaptina e vetme e cila nuk përmban asnjë Besmele. Meqë në një kaptinë mungon një Besmele dhe e dimë se janë 114 kaptina në Kur'an, pse atëherë Kur'ani përmban 114 Besmele dhe jo 113? Përgjigja është kjo: një kaptinë tjetër, surja En-Neml, përmban një Besmele shtesë, pra ajo ka 2 në vend të 1 Besmeleje.

Përveç Besmeles, para fillimit të sures En-Neml, ajeti 30 i këtij kapitulli thekson:

---

<sup>15</sup> Sahih El-Buhari, Volumi 8, Libri 75, Nr. 419

“(e lexova) **Kjo është prej Sulejmanit** (mandej e hapi, kur qe, në të) **"Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirë Bërësit (Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim!)"**. (En-Neml, 27:30).

Duke i qartësuar këto fakte, jemi dëshmitarë të përsëritjes të jashtëzakonshme të Besmeles, (بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ), në secilën kaptinë të Kur'anit! Rregullimi vijues do të jetë më i madhi deri më tash, një numër 114-shifror, derisa thjeshtësia e tij është po aq madhështore sa edhe gjatësia e tij.

Për të ndërtuar këtë rregullim, thjeshtë do të shikojmë numrin e Besmeles në secilën kaptinë të Kur'anit. Siç e dimë , çdo kaptinë në Kur'an përmban vetëm një Besmele, me përjashtim të dy kaptinave, kaptina 9 dhe kaptina 27. Kaptina 9 nuk përmban asnjë Besmele, ndërsa kaptina 27 përmban 2 Besmele. Kështu që, ne do t'ia shoqërojmë secilës kaptinë numrin 1, përveç kaptinave 9 dhe 27, të cilave do t'ia shoqërojmë numrat 0 dhe 2 përkatësisht. Kjo nënkupton që në këto 114-shifra, 0 do të jenë 9-të shifra nga ana e djathtë, 2 do të jenë 27-të shifra nga e djathta, dhe pjesa tjetër e shifrave do të jetë 1:

111111111112111111111111111111111011111111
11
11

Ky numër kaq i madh, për habinë tonë, është i plotpjesëtueshëm me 7, kur e lexojmë nga të dy anët. Me fjalë të tjera, nëse lexohet normalisht, nga ana e majtë në të djathtë, ne gjejmë :

11
11
11111111121111111111111111111011111111 =
158730158730158730158730158730158730158730158

**730158730158730158730187301587301587301  
5873015887301587301587301587301573015873 x 7**

Kur lexohet prej të djathtës në të majtë, do të kemi:

**11111110111111111111111111111112111111111111  
111  
11 =  
158730157301587301587301587301588730158730158  
730158730158730158730158730158730158730158730  
15873015873015873015873015873015873 x 7**

Për më tepër, ky numër i madh mund të ndahet në 19 pjesë dhe çdo pjesë është shumëfish i 7. Por pse ky numër, i cili paraqet rregullimin e Besmeles përgjatë tërë kapitujve të Kur'anit, të ndahet në 19 pjesë? Ndoshta sepse vetë Besmeleja në vetvete përmban 19 shkronja? Këto pjesë janë si në vijim:

**- 111111 - 1112111 - 111111 - 111111 - 11011 - 111111 -  
- 111111 - 111111 - 111111 - 111111 - 111111 - 111111 -  
111111 - 111111 - 111111 - 111111 - 111111 - 111111 - 111111**

Qëndrimi i ynë final në këtë pjesë është se jemi të mahnitur. Saktësia e rregullimit të Besmeles në Kur'an është mahnitëse. A ka mundësi që ky rregullim masiv të ketë ndodhur rastësisht që të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin 7 dhe atë nga të dy anët? A mundet fati të ketë luajtur pjesën e tij në prodhimin e 19 pjesëve të ndryshme prej këtij rregullimi, të cilat të gjitha plotpjesëtohen me 7? Ky është një koncept i ndërlikuar që të shpjegohet, por është besimi ynë që vetëm urtësia e pakufishme e All-llahut të Plotfuqishëm mund të prodhoj numra të tillë të shkëlqyer. Sikur kaptina 9 (surja Et-Tevbe) të përmbante 1 Besmele në vend të 0, rregullimi i mësipërm do të ishte shkatërruar tërësisht, sepse

rezultati i numrit nuk do të ishte i plotpjesëtueshëm me 7. Jo vetëm kaq, por edhe sikur kaptina 8 ose 10 të përmbante 0 Besmele në vend të kaptinës 9 – pra sikur shifra e 8-të ose 10-të të ishin 0 e jo shifra e 9-të - rregullimi do të ishte shkatërruar.

Në të njëjtën mënyrë, sikur kaptina 27 (surja En-Neml) të përmbante vetëm 1 Besmele dhe jo 2, rregullimi do të ishte shkatërruar sërish, dhe sikur këto 2 Besmele të ishin në vend të kaptinave 26 ose 28, e njëjta pasaktësi do të kishte rezultuar. Me fjalë të tjera, këto anomalit e 0 dhe 2 nevojitet të vendosen me maturi pikërisht në këto vende, përndryshe rregullimi numerik nuk do të ishte i mundur, dhe kjo, vetëm, është me të vërtetë diçka që duhet të vlerësohet.

## PËRMBLEDHJE

Siç kemi shpjeguar në pjesët e mëparshme, rëndësia e numrit 7 në Universin tonë është e jashtëzakonshme dhe që nuk duhet të injorohet. Kur'ani i Shenjtë, Shkrimi i fundit i All-llahut të Plotfuqishëm, nuk e injoron rëndësinë e tij. Urtësia e All-llahut e ka përcaktuar ajetin e parë të Librit të Tij Besmelen, ajeti i cili fshehë shumë mistere të mrekullueshme, ndër të cilat është një sistem i ndërlikuar numerik në pajtim me këtë numër.

Ne ishim dëshmitarë të disa sekreteve prapa këtij sistemi numerik. Për shembull, ne kemi parë se si fjalët dhe madje edhe shkronjat e Besmeles janë shumë të ndërlidhura me disa ajete tjera dhe kaptina të Kur'anit. Gjithashtu, në numrin e ajetit dhe numrin e kaptinës të Besmeles pati madje më tepër konsistencë me numrin 7, veçanërisht me mënyrën se si këto ndërlidheshin me numrat e kaptinave dhe ajeteve përgjatë Kur'anit.

Përveç kësaj, ne pamë rregullimin e 10 shkronjave të Besmeles në fjalë të ndryshme dhe ajetet e Kur'anit, veçanërisht në lidhje me “El-Muavvedhetejn” (dy kapitujt e shpëtimit (strehimit) dhe “Ajetul-Kursi – Tesbi dova” (Ajete i Fronit) dhe se si të gjithë këta shembuj prodhojnë shumëfish të numrit 7.

Përfundimisht, duke u zhytur në bukuritë intriguese të këtij ajeti të vetëm, duke reflektuar mbi mrekullitë dhe precizitetin e rregullimit të saj, thellësia e saj duket se nuk ka kufi. Si rezultat i nevojshëm, pa marrë parasysh se sa të thellë e mendojmë të jetë Kur'anin, ai edhe më shumë dëshmon mrekulli, dhe pa marrë parasysh se sa mrekulli ne mendojmë se ai ka, të tjerat vazhdojnë të realizohen.

**KAPITULLI - II -****MREKULLIA NDODHET NË ÇDO AJET DHE NË ÇDO FJALË**

*Në këtë pjesë, zbulojmë të vërtetat e reja brenda sistemit numerik të shkronjave të mrekullueshme të Kur'anit të Shenjtë. Sërish do të dëshmojmë, se secili varg (ajet) përmban një mrekulli mahnitëse numerike dhe meriton meditim dhe reflektim.*

*Do të zgjedhim vargje të ndryshme nga Kur'ani Fisnik, me qëllim që me anë të shembullit të tregojmë se All-llahu i Plotfuqishëm ka lënë në çdo ajet të Tij një numër (ose më shumë!) i cili është i plotpjesëtueshëm me numrin 7. Shembull konkret që asnjë njeri nuk mund ta imitojë një ajet (madje asnjë fjalë, siç do të dëshmojmë në vijim) të ngjashëm me atë në Kur'an.*

*Me të vërtetë, njëra ndër mrekullitë kyçe në këtë Libër është se në çdo ajet dhe shpesh në fragmente të ajeteve, madje edhe në fjalët e thjeshta ndodhet mrekullia, dhe pikërisht kjo është ajo që do të mundohemi ta ilustrojmë në faqet që vijojnë.*

**“...dhe padyshim do të kujdesemi për Të...” - një betim për ta mbrojtur Kur'anin**

Nëse studiojmë çdo varg të Kur'anit të Shenjtë nga pikëpamja numerike, do të gjejmë një sistem mahnitës të bazuar në numrin 7 dhe shumëfishet e tij. Sa për fillim, do të studiojmë një ajet të bukur ku All-llahu i Plotfuqishëm betohet që do ta ruajë dhe do ta mbrojë Kur'anin e Shenjtë nga çfarëdo ndryshimi. Në këtë ajet, Ai ka siguruar çdo shkronjë të këtij ajeti të shkëlqyer çka dëshmon se Kur'ani kurrë nuk ka qenë i ndryshuar nga asnjëri! Ky ajet i “betimit” drejtpërsëdrejti i përgjigjet çdo skepticizmi që vë në dyshim autenticitetin e Kur'anit. Por, çfarë lidhje ka kjo me



gjuhën a numrave? Nëse flasim numerikisht, çfarë ofron ky varg për ne?!

Zoti i Plotfuqishëm thotë:

“ انا نحن نزلنا الذكر و انا له لحفظون ”

*“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij”* (El-Hixhr, 15:9).

Tani do të vështrojmë lidhjen mahnitëse të këtij ajeti me numrin 7, lidhje e cila paraqet pikënisjen e të gjitha studimeve tona në Kur'an ndaj mrekullisë numerike. Jo vetëm që do të zbulojmë shembuj të shumtë që janë në përputhshmëri të plotë me këtë numër, por edhe do të kuptojmë se i tërë sistemi numerik i këtij ajeti do të shkatërrohej po që se një shkronjë e vetme do të ishte shtuar apo hequr nga ky ajet; apo të ishte ndryshuar ndonjë fjalë e vetme; ose të ishte shkruar në mënyrë tjetër sado të ngjashme.

Për shembull, fjala **“leháfídhúne”** që tregon betimin e Zotit për të ruajtur Kur'anin, me domethënie, **“Ne do ta ruajmë atë”**, dallon mes të shkruarit në Arabishten Kur'anore dhe Arabishten e zakonshme.

Siç është theksuar më poshtë:

<b>Arabishte Kur'anore:</b>	<b>Arabishte e zakonshme:</b>
لحفظون	لحافظون

Siç mund të shohim, arabishtja e zakonshme e kësaj fjale përmban një shkronjë “Elif” më shumë. Po që se kjo formë e të shkruarit do të ishte në Kur'an, atëherë asnjë nga këta shembuj që do të vështrojmë nuk do të ishte në përputhshmëri me numrin 7.

Gjithashtu për ata që nuk e njohin gjuhën arabe, vlen të përmendim se në arabishte shkronja (و) në rastet kur nuk është e lidhur me asnjë fjalë, ka kuptimin e lidhëzës “dhe” d.m.th edhe pse është një shkronjë e vetme, kjo ka rolin e lidhëzës në fjalinë e tërë. Për shembull, shkronja (و) në fjalën (لحفظون) nuk është e vetme, është vetëm tingull në fjalën e dhënë, pra në këtë rast nuk e ka kuptimin e lidhëzës “dhe/ e/ edhe”. Sidoqoftë, në ajetin e dhënë më poshtë, kjo shkronjë qëndron e vetme, pra nuk është e lidhur as para as pas me ndonjë fjalë tjetër dhe ka kuptimin e fjalës “dhe”:

“ انا نحن نزلنا الذكر و انا له لحفظون ”

### Shkronjat e para dhe ato të fundit të ajetit

Fjala e parë në ajetin e dhënë është (ان) - që ka kuptimin e përemrit vetor “Ne”, ndërsa fjala e fundit në këtë varg është (نوظفحل) - kuptimin “S’ka dyshim se ne do ta ruajmë atë”. Në vijim do ta shkruajmë ajetin e tërë duke numëruar shkronjat që nga fjala e parë e deri në fjalën e mbarimit të këtij ajeti:

(ان) (ا ن ا)	نحن نزلنا الذكر و انا له لحفظون (ل ح ف ظ و ن)
3	6

Numri që fitohet pas numërimit të shkronjave të fjalës së parë dhe asaj të fundit është numri 63, pra, shumëfishi ynë i parë i numrit 7:

$$63 = 9 \times 7$$

### Shkronja e parë

Shkronja e parë në këtë varg është ‘Elif’ nga fjala ‘ان’, dhe shkronja e fundit është ‘Nunë’ (ن), nga fjala ‘نوظفحل’. Tani do të

shohim se si fjalët që përmbajnë këto dy shkronja, aranzhohen në përputhshmëri të plotë me numrin 7. Do t'i përmbahemi një rregulli të thjeshtë duke filluar me shkronjën e parë:

- Çdo fjalë e cila përmban shkronjën Elif do të përfaqësohet me numrin 1.
- Çdo fjalë e cila nuk përmban shkronjën Elif do të përfaqësohet me numrin 0.

Tani do ta shkruajmë ajetin e tërë me pasqyrim të shkronjave të secilës fjalë, të atyre që përmbajnë dhe atyre që nuk përmbajnë tingullin Elif:

لحفظون	له	انا	و	الذكر	نزلنا	نحن	انا
0	0	1	0	1	1	0	1

Numri 00101101 është numër i plotpjesëtueshëm me 7:

$$101101 = 14443 \times 7$$

### Shkronja e fundit

Ashtu siç vepruam me shkronjën e parë të këtij ajeti, të njëjtin rregull do ta aplikojmë edhe me shkronjën e fundit. Do të shikojmë fjalët të cilat përmbajnë shkronjën e fundit të këtij ajeti, d.m.th. shkronjën 'Nunë'. Të përkujtojmë se rregulli është i njëjtë: kur ky tingull ndodhet në fjalë, e paraqesim numrin 1, ndërsa në fjalën që ky tingull nuk ekziston, e paraqesim numrin 0.

لحفظون	له	انا	و	الذكر	نزلنا	نحن	انا
1	0	1	0	0	1	1	1

Numri 10100111 është gjithashtu numër i plotpjesëtueshëm me 7:

$$10100111 = 1442873 \times 7$$

Dhe kështu shohim se shkronja e parë në këtë ajet është e përhapur nëpër fjalë në atë mënyrë që të formojë numrin e plotpjesëtueshëm me 7. E njëjta gjë vlen edhe për shkronjën e fundit të këtij ajeti! A mund të jetë kjo një rastësi? Të vazhdojmë tutje.

### Shkronjat e ajetit

Numri total i shkronjave të këtij ajeti është 28, numër ky i cili është i barabartë me numrin e shkronjave të alfabetit arab. Natyrisht, edhe ky numër është i plotpjesëtueshëm me 7:

$$28 = 4 \times 7$$

Ajo që është interesante është mënyra se si këto shkronja janë përhapur nëpër këtë ajet. Tani po e shënojmë ajetin e tërë, duke numëruar shkronjat e secilës fjalë:

لحفظون	له	انا	و	الذکر	نزلنا	نحن	انا
6	2	3	1	5	5	3	3

Numri 62315533 është i plotpjesëtueshëm me 7:

$$62315533 = 8902219 \times 7$$

Është mahnitëse kur vërejmë se ajeti i cili flet për ruajtjen e Kur'anit përbëhet prej gjithsej 28 shkronja, fakt ky jo vetëm i numrit total të shkronjave të alfabetit por edhe i plotpjesëtueshëm me 7. A thua edhe kjo është një rastësi? Në këtë rast, të shohim më tutje.

## Harmonia me vitet e shpalljes Kur'anore

Siç e pamë edhe ne në këtë ajet, renditja e numërimit të këtyre shkronjave na ka dhënë numrin 62315533. Duke studiuar tutje këtë numër, shohim se edhe ky numër është i plotpjesëtueshëm me numrin 23! Me fjalë tjera, ky është pikërisht numri i viteve të shpalljes së Kur'anit.

$$62315533 = 2709371 \times 23$$

Të sqarojmë se ky numërim i ajetit i cili flet për ruajtjen e Kur'anit, pra është pikërisht numri i viteve të zbritjes së këtij Libri për njerëzimin.

## Harmonia me ajetin e parë Kur'anor

Në këtë ajet ekziston lidhshmëria e paparë me ajetin e parë Kur'anor (Besmelen), ose:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Në emër të Zotit, Madhështor, Mëshirëplotë**

(El-Fatiha 1:1)

Tani do të shohim një numër të aranzhimeve lidhur me këtë varg dhe me fjalët në të. Dhe natyrisht, e gjithë kjo, gjithmonë në plotpjesëtueshmëri me numrin 7.

## Numrat e ajeteve

Ajeti “Besmeleja” është ajeti nr 1, ndërsa ajeti që ne po e thërrasim, ajeti i “betimit” është ajeti i 9 i kaptinës relevante:

<b>Besmeleja</b>	<b>Betimi</b>
<b>1</b>	<b>9</b>

Aranzhimet e sipërme na japin numrin 91, që sërish është numër i plotpjesëtueshëm me numrin 7.

$$91 = 13 \times 7$$

### Numrat e fjalëve

Ajeti i 'Besmeles' është i përbërë nga 4 fjalë, ndërsa ajeti i Betimit është i përbërë nga 8 fjalë.

<b>Ajeti i 'Betimit'</b>	<b>'Ajeti i Besmeles'</b>
<b>8</b>	<b>4</b>

Numri 84 është po ashtu numër i plotpjesëtueshëm me 7:

$$84 = 12 \times 7$$

Të shohim se çka do të ndodhë nëse i marrim në konsideratë edhe numrat e kaptinave të këtyre ajeteve.

### Numrat e kaptinave dhe ajeteve

Ajeti i 'Besmeles' gjendet në kaptinën numër 1 të Kur'anit, ndërsa ajeti i 'Betimit' në kaptinën 15:

Ajeti i Betimit		Ajeti i Besmeles	
1		15	
Numri i ajetit	Numri i kaptinës	Numri i ajetit	Numri i kaptinës
9	15	1	1

$$91511 = 13073 \times 7$$

**Numrat e vargjeve me kaptinat e Kur'anit**

**Numri i përgjithshëm i të gjitha kaptinave në Kur'an është 114, dhe ajeti i Betimit është ajeti i 9 i Sures El-Hixhr (kaptina 'Toka Shkëmbore')**

Ajeti i Betimit Numri i ajetit	Kaptinat e Kur'anit Numri i përgjithshëm
8	114

Numri 9114 është dy herë i plotpjesëtueshëm me numrin 7:

$$9114 = 186 \times 7 \times 7$$

Kuptohet se mund të ketë dyshime dhe skepticizëm ndaj kalkulimit të lartshënuar. Që të largojmë çdo mundësi rastësie, do të marrim shembull numrin e ajetit të 'Ajetit të Betimit' me numrin total të ajeteve në Kur'an. Rastësia, natyrisht, zvogëlohet kur përmbajtja e njejtë përsëritet edhe me numërimin e të gjitha ajeteve të Kur'anit dhe sërish fitohet numri 7 i dyfishuar.

## Numri i ajetit me numrat e ajeteve në Kur'an

Siç e dimë tani më, ajeti i 'Betimit' është ajeti numër 9 në suren El-Hixhr, derisa gjithsej në Kur'an janë 6236 ajete:

Vargjet e Betimit Numri i ajetit	Vargjet në Kur'an Numri i total i vargjeve
9	6263

Jo vetëm që është numër i plotpjesëtueshëm me 7, por ashtu si edhe në shembullin paraprak ky numër është dy herë i plotpjesëtueshëm me numrin 7!!!

$$96236 = 1964 \times 7 \times 7$$

Në që të dy shembujt e mësipërm shohim se kjo s'mund të jetë asgjë tjetër veç se një shenjë nga Zoti i Plotfuqishëm se është pikërisht Ai i cili i ka vënë numrin 9 këtij ajeti të Betimit në mënyrë që të na sigurojë se Ai e ka mbrojtur çdo kaptinë dhe çdo varg të Librit të Tij sepse numri i këtij ajeti përshtatet në mënyrë të mrekullueshme edhe me numrin total të kaptinave, edhe me numrin e vargjeve në Kur'an!

## Dy përpjesëtimet e fundit: edhe më shumë shumëfishe

Përpjesëtimi është rezultati i ndarjes së numrave. Pra, që të dy shembujt e mësipërm kanë prodhuar përpjesëtimet e fundit të numrit **186** dhe **1964**. Është e mahnitshme se këta dy numra janë sërish të lidhur me numrin 7. Fillimisht, kur i radhisim këta dy numra njërin pranë tjetrit, fitojmë numrin e plotpjesëtueshëm me 7:



$$1964186 = 280598 \times 7$$

Më pas, kur bëjmë llogarinë e gjithë këtyre numrave fitohet një numër tjetër gjithashtu i plotpjesëtueshëm me 7, pra numri 35:

$$1 + 9 + 6 + 4 + 1 + 8 + 6$$

Pra, me reflektimin e këtyre dy rezultateve, ajo çka pikërisht dëshmohet është se po të ndërrohet ose zëvendësohet, të hiqet apo shtohet vetëm njëri nga numrat në kaptinë apo ajet, i tërë sistemi të cilin sapo e zbuluam, do të shkatërrohej dhe nuk do të ekzistonte si i tillë.

Natyrisht, ky fakt dëshmon se mrekullia Kur'anore shtrihet edhe në numërimin e Tij. Pra, është diçka që Zoti ka krijuar dhe thjeshtë, nuk mund të ndryshohet assesi.

### Shkronjat e veçanta

E kemi përmendur më herët se Kur'ani përmban “frazë të veçanta” të qarta në fillimin e 29 kapitujve. Këto fraza të veçanta përbëhen nga 14 shkronja:

ا	ل	م	ص	ر	ك	ه	ي	ع	ط	س	ح	ق	ن
---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Shtatë (7) nga këto shkronja janë të përfshira në ajetin e Betimit dhe për të deshifruar më lehtë lexuesit, ajeti i Betimit është ky:

ا	ن	ح	ن	ز	ل	ن	ا	ل	ذ	ك	ر	و	ا	ن	ا	ل	ه	ل	ح	ف	ظ	و	ن
---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Shkronjat e veçanta janë:

ن	ح	ه	ك	ر	ل	ا
---	---	---	---	---	---	---

Është shumë interesante se si këto 7 shkronja gjinden pikërisht në këtë ajet ku numri 7 është bazë.

### Fjalët që përmbajnë shkronjat e veçanta

Në ajetin e Betimit, të shkruar më poshtë, do të vendosim numrat nën çdo fjalë, sipas shembullit në vijim:

- Fjalët të cilat përmbajnë ndonjërin nga shkronjat e veçanta do t'i shënojmë me numrin 1;
- Fjalët të cilat nuk përmbajnë asnjë nga shkronjat e veçanta do t'i shënojmë me numrin 0.

لحفظون	له	انا	و	الذكر	نزلنا	نحن	انا
1	1	1	0	1	1	1	1

$$11101111 = 1585873 \times 7$$

Dhe sa për të pasur rezultatin tonë edhe më bindës, nëse e analizojmë këtë numër, do të gjejmë se ky numër është gjithashtu i plotpjesëtueshëm edhe me numrin 23: pra, numri i viteve të shpalljes Kur'anore!

$$11101111 = 482657 \times 23$$

### Numrat e mbledhur, shembull mahnitës

Njëra nga karakteristikat mahnitëse të Kur'anit është sistemi i veçantë numerik i numrave të mbledhur të gjetur në disa nga kaptinat dhe ajetet e tij.

Tanimë e kemi dëshmuar këtë shembull me suren El-Fatihah dhe suren El-Ihlas. Fatmirësisht, do të kemi edhe shembuj tjerë në

ajetet tjera, duke përfshirë edhe këtë ajet. Më poshtë, do të shkruajmë ajetin në tërësi dhe nën secilën fjalë do të kemi numërimin e shkronjave dhe së bashku me numërimin e shkronjave të fjalës paraprahe:

لحفظون	له	انا	و	الذکر	نزلنا	نحن	انا
28	22	20	17	16	11	6	3

Numri që kemi fituar është 28222017161163, ky shembull ka tri karakteristika të veçanta:

1. Është numër 14 shifror ose  $2 \times 7$ .
2. Mbledhja e këtyre shifrave është si vijon:

$2 + 8 + 2 + 2 + 2 + 0 + 1 + 7 + 1 + 6 + 1 + 1 + 6 + 3 = 42$
$42 = 6 \times 7$

3. Është numër i plotpjesëtueshëm me 7:

$28222017161163 = 4031716737309 \times 7$
---

Dhe tani do të vazhdojmë tutje me ajetin, i cili ka mrekulli të ndryshme si shkencore, gjuhësore, dhe mrekulli numerike.

### “Ne e zgjerojmë Hapësirën”

Shkencëtarët e sotëm flasin për zgjerimin e Universit dhe nocioni se Universi jonë është duke u zgjeruar, është një fakt. Sidoqoftë, ky fakt nuk u zbulua deri në shek. XX, bazuar në përmirësimin e burimeve, diturisë dhe hulumtimit në fushën e astronomisë, por gjithashtu edhe duke u bazuar në teknologjinë e avancuar si dhe të diqkaje që ne shpesh e marrim si asgjë, e që është gjuha e numrave.

Kur e themi këtë, vërejmë se Kur'ani i Shenjtë ka ecë një hap më tutje duke e sqaruar këtë fakt dhe atë jo me më shumë se shtatë fjalë:

والسَّمَاءُ بَنِيهَا بِأَيِّدٍ وَأَنَا لِمُوسَى

*“Ne, me forcën Tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë”*  
(Edh- Dharijat 51:47).

Në këtë ajet është një mrekulli shkencore, sepse qartazi flet për zgjerimin e Universit përmes fjalës (الموسعون) e cila është konfirmim i kuptimit “Jemi Ne ata që e zgjerojmë hapësirën”. Pra, ky fakt është shpallur në Kur'an 14 shekuj para se shkenca bashkëkohore ka arritur të zbulojë diçka të tillë. Por tani, ne do të shohim edhe mrekullitë numerike që lidhen me këtë ajet.

### Shkronjat e çdo fjale

Tani do të shkruajmë ajetin e “Universit” së bashku me numërimin e shkronjave të secilës fjalë në të:

و	السَّمَاءُ	بَنِيهَا	بِأَيِّدٍ	و	أَنَا	لِمُوسَى
1	5	6	5	1	3	7

Numri 7315651 është dy herë i plotpjesëtueshëm me numrin 7!

$$7315651 = 149299 \times 7 \times 7$$

Po ta lexojmë këtë numër nga ana kundërt, sërish do të fitojmë numër të plotpjesëtueshëm me 7:

$$1565137 = 223591 \times 7$$

Çuditërisht, edhe nëse i kombinojmë (bashkojmë) këto dy rezultate, pra numrat 223591 dhe 149299, sërisht do të kemi një numër të plotpjesëtueshëm me 7, pra 223591149299, ky është numër 12 shifror i plotpjesëtueshëm me 7!

$$223591149299 = 31941592757 \times 7$$

Edhe po që se i ndërrojmë vendet këtyre dy numrave që bashkuam, pra e vendosim numrin 149299 para numrit 223591, ne sërisht fitojmë numër të plotpjesëtueshëm me 7:

$$149299223591 = 21328460513 \times 7$$

Dhe jo vetëm kaq, por edhe kur mblidhen këta dy numra, pra 223591 dhe 149299 sërisht krijojnë një numër të plotpjesëtueshëm *dy herë* me numrin 7!

$$223591 + 149299 = 372890$$

$$372890 = 7610 \times 7 \times 7$$

Po të lexojmë nga ana e kundërt numrin 372890, që është shuma e dy numrave tonë, prapë do të kemi numër të plotpjesëtueshëm me 7, që është numri 098273:

$$98273 = 14039 \times 7$$

### **Shkronjat e ajetit**

Numri i fjalëve në këtë ajet është 7 dhe përbëhet nga gjithsej 28 shkronja, numër ky, sërisht i plotpjesëtueshëm me numrin 7:

$$28 = 4 \times 7$$

Kur'ani i Shenjtë u shkrua në mënyrë unike në kohën e Pejgamberit tonë (s.a.v.s.) përafërsisht 1400 vite më parë.

Për shembull, fjala (ءامسلا) nuk përmbante shkronjën (ët ,ء) njohur si “Hemze”. Po që se do të përmbante këtë shkronjë, fjala do të përbëhej nga 6 shkronja e jo nga 5, gjë që do të rrëronte shembullin numerik që sapo e pamë më lart.

Në vazhdimësi, fjala ( نذيناها ) “*Ne ndërtoam (d.m.th. Gjithësinë)*”, në Kur'an është e shkruar pa shkronjë “Elif” ( ا ), pra: ( انينب ). Po që se do të shkruhej me rregullat e Arabishtes së zakonshme, pra me një shkronjë shtesë, shembujt e mësipërm nuk do t'i kishim ashtu siç i kemi, pra do të shkatërrohej shembulli në tërësi.

Gjithashtu, hasim në rastin mahnitës të fjalës (بأييد), që ka domethënien “*me fuqi dhe aftësi*”. Kjo fjalë, në gjuhën e zakonshme, pra të rregullt, Arabe përbëhet nga 4 shkronja, por në Kur'an gjendet e shkruar me një shkronjë më shumë “j-e e heshtur” ( ي ) që në këtë rast numërohen si 5 shkronja. Pra edhe në këtë rast, po që se nuk do të kishim edhe këtë dallim të vogël, pra nuk do të kishim shembullin ekzistues numerik.

Këto detaje të përfshira janë dëshmi e madhe e precizitetit të shkëlqyer në fjalët Kur'anore, dhe Zoti i Plotfuqishëm e ka vendosur qëllimisht secilën fjalë në vendin përkatës të këtij Libri të mrekullueshëm, sepse asnjë njeri nuk do të kishte përpikërinë e tillë të përkushtuar në detaje aq të ndërlikuara.

## Shkronjat e veçanta

Ta rikujtojmë që shkronjat e veçanta në Kur'an janë:

ا	ل	م	ص	ر	ك	ه	ي	ع	ط	س	ح	ق	ن
---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Do të shkruajmë sërish ajetin e tërë, në mënyrë që të shohim se cilat nga shkronjat e veçanta i përmban ky ajet:

والسما ع بن ي ن ه ا ب ا ي ي د و ا ن ا ل م س ع و ن

Pra, shkronjat e veçanta të këtij ajeti janë:

ع ن ه س ا ل م ي

Pra, përderisa shikojmë këto shkronja në çdo fjalë të këtij ajeti, fitojmë shembullin si në vijim:

و	السما ع	بنينها	بأييد	و	انا	لموسعون
0	5	5	3	0	3	5

Ky numër 5303550 është numër i plotpjesëtueshëm me 7 madje edhe nëse e lexojmë nga të dy drejtimet e mundshme:

$$5303550 = 757650 \times 7$$

$$553035 = 79005 \times 7$$

Gjithashtu edhe numri i përgjithshëm i shkronjave të këtij ajeti është i plotpjesëtueshëm me 7:

$$5 + 3 + 3 + 5 + 5 = 21$$

$$21 = 3 \times 7$$

Pasi që numri i përgjithshëm i shkronjave të veçanta në këtë varg është 28, numri i shkronjave të rregullta, pra të zakonshme “jo të veçanta” është 7, dhe tani do të shohim edhe mënyrën e veçantë si këto shkronja lidhen përgjatë këtij ajeti.

## Shkronjat jo të veçanta të ajetit

Tashmë kemi numëruar shkronjat e veçanta të këtij ajeti. Pra, mbesin edhe shkronjat e rregullta, ato të zakonshme, që nuk janë të veçanta dhe të shohim se si ato shtrihen përgjatë këtij ajeti:

و	السماء	بنينها	بأييد	و	انا	لموسعون
1	0	1	2	1	0	2

Numri 2012101 ashtu si edhe numri që fituam nga shkronjat e veçanta, d.m.th nga cila do anë që lexohet, është numër i plotpjesëtueshëm me 7:

$2012101 = 287443 \times 7$
$1012102 = 144586 \times 7$

Me fjalë tjera, kemi ajetin e përbërë nga 7 fjalë, 4 x 7 fjalë, 3 x 7 shkronja të veçanta, 7

shkronja të zakonshme (të gjitha shkronjat japin numër të plotpjesëtueshëm me 7!) dhe edhe vet ajeti flet për Qiellin, i cili, sipas Kur'anit të Shenjtë, është 7 (d.m.th. 7 Qiej)!

## Shkronjat e “Er-Rahmān” (نمحرل)

Emri i Zotit të Plotfuqishëm “Er-Rahman”, që ka kuptimin e ‘Mëshirëplotit’, gjithashtu i ka shkronjat e shpërndara në mënyrë të ndërlidhur me numrin 7. Këto janë shkronjat e emrit të Tij:

الرحمن

و	السماء	بنينها	بأييد	و	انا	لموسعون
0	4	3	1	0	3	3



$$3301340 = 471620 \times 7$$

Numri total i shkronjave në “Er-Rahman” është gjithashtu i plotpjesëtueshëm me 7:

$$3 + 3 + 1 + 3 + 4 = 14$$

$$14 = 2 \times 7$$

### Shkronjat e Besmeles

Shkronjat e ajetit të parë në Kur'an, pra ajetit të Besmeles, janë gjithashtu të shpërndara në pajtueshmëri me numrin 7. Ky është ajeti i Besmeles:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

(Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim)

Shkronjat e këtij ajeti, janë:

ب س م ا ل ه ر ح ن ي

Kur këto shkronja kërkojnë në ajetin e Universit, kemi numrin si në vijim:

و	السماء	بنيها	بأييد	و	انا	لموسعون
0	5	6	4	0	3	4

Numri i fituar 4304650 është tri herë i plotpjesëtueshëm me numrin 7!!!

$$4304650 = 12550 \times 7 \times 7 \times 7$$

## Lidhja me Basmelen

Sa i përket numrit të kapitullit, numrit të ajetit dhe numërimit të fjalëve, ekziston një lidhje e madhe mes ajetit të Besmeles dhe ajetit të Universit. Besmeleja gjendet në suren El-Fatihah, e cila është kaptina e parë në Kur'an. Ai është ajeti i kaptinës dhe nuk përmban më shumë se 4 fjalë. Ajeti që na flet për zgjerimin e Universit, është ajeti numër 47 i kaptinës numër 51 në suren 'Edh-Dharijat' dhe ai përmban 7 fjalë. Kur i shënojmë gjithë këta numra më poshtë, fitojmë shembullin:

Ajeti i zgjerimit të Universit			Ajeti i Besmeles		
Fjalët	Ajeti	Kaptina	Fjalët	Ajeti	Kaptina
7	47	51	4	1	1

Numri që fituam është 74751411, numër dy herë i plotpjesëtueshëm me 7!

$$74751411 = 1525539 \times 7 \times 7$$

Edhe po ta lexojmë këtë numër anasjelltas, sërish kemi numër të plotpjesëtueshëm me 7:

$$11415747 = 1630821 \times 7$$

Ajo që na bie në mendje në lidhje me këta shembuj që sapo pamë, është *kreativiteti* i mrekullisë numerike në Kur'an, ku çdo ajet mban në vete sistemin e vet të veçantë numerik, si dhe sistemin e veçantë të lidhjes së shembujve.

Dhe tani, shtrohet pyetja: çfarë do të ndodh nëse e studiojmë vetëm një *fragment* të ajetit, dhe jo ajetin e tërë? A do të qëndrojë mrekullia numerike? Të shohim.

## Mrekullia në Fragment

Nga 28 shkronjat e alfabetit arab, Zoti i Plotfuqishëm, me mençurinë e Tij të paskajshme, ka zgjedhur tri për të emëruar Vetën e Tij, pra “Elif”(أ), “Lām”(ل) dhe “Hā”(ه). Këto shkronja, të cilat e përbëjnë fjalën “All-llah”, janë të lidhura në mënyrë të mrekullueshme përgjatë tërë ajeteve në Kur’an dhe është si një vulë e pashlyeshme për tërë njerëzimin, duke dëshmuar se ky Libër është fjala e Zotit, dhe se secila fjalë, në të, është fjala e Tij.

Me të vërtetë, mrekullia numerike e shkronjave, me emrin e All-llahut (الله) është një kryevepër spektakulare e cila shfaqet në kohërat e teknologjisë së sotme; një dëshmi e së vërtetës së Librit të Zotit.

## Kush është më i singertë se Zoti?

Duke iu drejtuar njerëzimit, Zoti i Plotfuqishëm thotë:

وَالَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَنُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا وَعَدَّ اللَّهُ حَقًّا وَمَنْ أَصْدَقُ مِنَ اللَّهِ قِيلًا

***“Por atyre që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, - ne do të iu tregojmë kopshtet, me lumenj që rrjedhin nën to, - dhe aty do të jetojnë përfundimisht. Premtimi i Zotit është e vërteta, dhe fjala e kujt mund të jetë më e singertë se ajo e Zotit?”*** (En-Nisa, 4:122)

Fragmenti i fundit i këtij ajeti, thotë:

و من أصدق من الله قيلا

“..dhe fjala e kujt mund të jetë më e sinqertë se ajo e Zotit?!”.

Kjo pyetje, e shtruar në Kur'anin e Shenjtë, për gjithë njerëzimin, është pyetje retorike e cila pyet:

A mund të ekzistojë dikush i cili është më i saktë dhe i sinqertë se vet Krijuesi i qiellit e tokës?

Por, a ka nevojë Zoti i Plotfuqishëm, Krijuesi i shtatë qiejve, të bëjë një pyetje të tillë? A ka nevojë Ai për dikë që t'i besojë Atij? Sigurisht se nuk ka nevojë për asnjërin, por e shtron këtë pyetje nga mëshira që ka për njerëzimin, thjeshtë për t'i bërë të besojnë.

Sidoqoftë, jemi optimistë andaj themi: nëse gjuha e fjalëve nuk është e mjaftueshme, që kemi rastin e njerëzve të panumërt, atëherë gjuha e pamohueshme e numrave thjeshtë nuk mund të refuzohet.

Dhe tani, do të vazhdojmë rrugëtimin (dhe fjalët e kujt mund të jenë më të sinqerta se ato të Zotit?!) dhe do të dëshmojmë sistemin brilant numerik prapa këtyre fjalëve të fuqishme, me qëllim që të sigurohemi se Zoti i Plotfuqishëm është autori i vetëm i tyre.

### Numërimi i shkronjave

Tani do të shënojmë ajetin e “rrugës së vërtetë” së bashku me numërimin e shkronjave:

ق	ي	ل	ا	ل	ه	و
4	4	2	4	2	1	

Numri 442421 është *dy herë* i plotpjesëtueshëm me 7.

$$442421 = 9029 \times 7 \times 7$$

## Lidhje mbresëlënëse me shkronjat e “All-llah”-ut

Tani më kemi shënuar shkronjat e fjalës “All-llah” (الله) dhe ato ishin:

ا ل ه
-------

Tani do të shikojmë këto shkronja në secilën fjalë të fragmentit të shënuar më poshtë dhe do të shohim se çfarë do të fitojmë:

قِيْلَا	الله	مَنْ	أَصْدَقْ	مَنْ	و
2	4	0	1	0	0

Numri 240100 prodhon një sërë numrash të plotpjesëtueshëm me 7:

<b>240100 = 34300 x 7</b>
<b>34300 = 4900 x 7</b>
<b>4900 = 700 x 7</b>
<b>700 = 100 x 7</b>

Sa mahnitshëm! Këtu kemi fragmentin që flet për Zotin, numrin që paraqet shkronjat e emrit të Zotit dhe është katër (4) herë i plotpjesëtueshëm me numrin 7, e po ashtu edhe numri i shkronjave në emrin e Zotit është 4. Jo vetëm kjo, por a s’është rezultati përfundimtar ai i cili na jep numrin 100, një vërtetim pothuajse përfundimtar se Kur’ani i Shenjtë është fjala e Zotit, 100%?

## Llogaritjet mahnitëse

Numri i cili fitohet kur një numër plotpjesëtohet me një numër tjetër, quhet herës. Sapo pamë se numri që përfaqësoi shembullin e numërimit të shkronjave të shtegut të së vërtetës është numri 442421, numër ky dy herë i plotpjesëtueshëm me numrin 7. Gjithashtu pamë se numri i cili përfaqësoi shkronjat e emrit “All-llah” në pasuesin e njëjtë është 240100, numër katër herë i plotpjesëtueshëm me 7.

Dhe tani, do të shënojmë sërish rezultatet e mësipërme dhe të vështrojmë se çfarë fitojmë në lidhje me rezultatet:

- Shembulli i numërimit të shkronjave të fragmentit në fjalë, jep shifrat në vijim:

$$442421 = 9029 \times 7 \times 7$$

- Shembulli i shkronjave në “All-llah” në po të njëjtin fragment, jep prodhimin:

$$240100 = 100 \times 7 \times 7 \times 7 \times 7$$

Ajo çka është me të vërtetë mahnitëse është fakti se nëse marrim dy rezultatet - 100 dhe 9029 - dhe i kombinojmë ato në një numër të vetëm, rezultati është një numër 7 shifror po ashtu i plotpjesëtueshëm me 7:

$$1009029 = 144147 \times 7$$

Por, ky nuk është fakti i vetëm mahnitës i rezultatit të fituar. Po ashtu nëse i mbledhim shifrat e numrit 1009029, do të fitojmë numër të plotpjesëtueshëm me 7:

$$1 + 9 + 2 + 9 = 21$$

$$21 = 3 \times 7$$

Dhe ende kemi shembuj me numër të shumëfishtë të numrit 7. Herësi i pjesëtimit të numrit 1009029 me 7 është 144147, siç tregohet edhe më lart.

Mrekullisht, shuma e shifrave të këtij herësi jo vetëm që është shumëfish i numrit 7, por është edhe shumëfishi i njëjtë si ai i numrit 1009029:

$$1 + 4 + 4 + 1 + 4 + 7 = 21$$

$$21 = 3 \times 7$$

Me fjalë të tjera, shuma e shifrave të numrit 1009029 është 21, njëjtë si shuma e shifrave të rezultatit kur ajo ndahet me 7, pra numrit 144147!

### **Përsëritja e shkronjave në fjalën “All-llah”**

ال ه

Tani do të shohim përsëritjen e shkronjave në fragment.

و من اصدق من الله قبيلا

- Numri i shkronjës “Elif” ( أ ) në këtë fragment është 3.
- Numri i shkronjës “Lām” ( ل ) në këtë fragment është 3.
- Numri i shkronjës “Hā” ( ه ) në këtë fragment është 1.

Shembulli i këtyre numrave na jep:

“Hā” ( ه )	“Lām” ( ل )	“Elif” ( ا )
1	3	3

Numri 133 është shumëfish i numrit 7:

$$133 = 19 \times 7$$

Po ashtu, edhe numri i shkronjave të fjalës “All-llah” në këtë varg është 7:

$$1 + 3 + 3 = 7$$

Dhe kështu shohim se në këtë fragment ku thuhet: “*..dhe fjalët e kujt mund të jenë më të vërteta se ato të All-llahut?*”, numri i shkronjave në “All-llah” është 7, dhe këto shkronja shpërndahen në tërë ajetin në mënyrë të tillë që sërish të japin shumëfishin e numrit 7. Dhe pasi shohim këtë, shtrojmë pyetjen: - Nëse Zoti i Plotfuqishëm i ka radhitur shkronjat e emrit të Tij në mënyrë shumë konsistente me numrin 7, a nuk do të mundej Ai të vendoste *pozicionin e saktë dhe më preciz* të emrit të Tij përgjatë këtij fragmenti në të njëjtën mënyrë? Të hedhim një vështrim më të përafërt në pozicionet e emrit të All-llahut nëpër fjalët e këtij fragmenti.

### **Vendi i veçantë i fjalës “All-llah” në fragmentin e së vërtetës**

Emri i “All-llahut” disponon vendin e veçantë në këtë fragment. Ai është në disa mënyra në pajtueshmëri të plotë me numrin 7, në aspektin e numërimit të fjalëve, të shkronjave ose të numrit të shkronjave që ndodhen para apo pas shkronjave të vendndodhjes së emrit “All-llah”.



Së pari, do të numërojmë se sa fjalë gjenden para dhe pas emrit “All-llah” në këtë fragment. Përveç fjalës “All-llah”, ky fragment përmban pesë fjalë të tjera, ku katër nga këto vijnë para emrit të Tij dhe një fjalë ndodhet pas emrit të Tij:

قِيلَا	اللّٰه	و من أصدق من
1		4

Ky shembull i thjeshtë, na jep numrin 14:

$$14 = 2 \times 7$$

Kur vështrojmë fragmentin më hollësisht, dhe kur marrim shembullin e njëjtë me numërimin e shkronjave të emrit ‘All-llah’ para dhe pas emrit “All-llah”, vërejmë se:

قِيلَا	اللّٰه	و من أصدق من
2		1

Është mahnitëse se edhe vet emri “All-llah” ka numër i cili është shumëfish i numrit 7:

$$21 = 3 \times 7$$

### Numrat e mbledhur

Sistemi i bukur i numrave të rreshtuar shfaqet edhe një here në këtë fragment. Tani do të paraqesim shembullin e formuar nga numërimi i shkronjave të secilës fjalë dhe numrave të rreshtuar.

و	من	أصدق	من	الله	قيلا
1	3	7	9	13	17
$17139731 = 2448533 \times 7$					

### Numrat e mbledhur të shkronjave në emrin “All-llah”

Tani do të kryejmë aktivitetin e njejtë të numërimit të numrave në shumën e rreshtuar, por këtë herë do të numërojmë vetëm tri shkronjat që e formojnë emrin e All-lahut, pra “Elif” (أ), “Lām” (ل), and “Hā” (ه)

و (و)	من (م ن)	أصدق (أ ص د ق)	من (م ن)	الله (ال ل ه)	قيلا (ق ي ل ا)
0	0	1	1	5	7

**Pra:**

$$751100 = 107300 \times 7$$

Pra, sado që ne mundohemi të ndërrojmë mënyrën e numërimit apo renditjes së numrave, prapëseprapë shohim se në këtë fragment përmbajtja e sistemit numerik është e mbrojtur në mënyrë mahnitëse, që është një dëshmi unike për Njësinë e Zotit të Plotfuqishëm. Kushdo që përballet me rezultatet e tilla, do të duhej patjetër të pyes: vallë, a do të mundej ndonjë qenie njerëzore të fliste për veten e tij në një fjali të vetme dhe atë me aq saktësi; duke paraqitur shtatë shkronjat e emrit të vet me aq precizitet në po të njëjtën fjali; duke siguruar që çdo përsëritje e këtyre shkronjave të jepë numër që është shumëfish i numrit 7 dhe për më shumë t’i radhisë ato shkronja në fjali në atë mënyrë që ato të japin numër të shumëfishtë si  $7 \times 7 \times 7 \times 7$ ?! Gjithashtu, ky

njeri do të duhej që të sigurohej se edhe vet emri i tij të prodhojë numrin e shumëfishit të 7-shit, po ashtu edhe *shkronjat* para dhe pas emrit të tij të japin shumëfishin e numrit 7 x 7, si dhe shkronjat para emrit të *tij* do të duhej të prodhojnë shumëfishin e 7-shit!

Por të jemi të sigurtë, a është kjo gjë e mundur për njerëzimin? Ky fragment i vetëm është një shembull i fuqishëm se si Zoti i Plotfuqishëm i ka siguruar jo vetëm fjalët në Kur'an por edhe shkronjat në të, gjë që siguron se asnjë krijesë nuk do të mund të prodhojë asnjë ngjashmëri me Librin e mrekullueshëm të Tij!

### **Ata nuk do të mund të prodhojnë asnjë ngjashmëri**

Kur flitet për ngjashmëritë me Kur'anin, Zoti i Plotfuqishëm thotë:

قُلْ لِّبِنِ أَجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَا

كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا

***“Thuaj: "Edhe po të mblidhen gjithë njerëzimi dhe xhinët së bashku me qëllim që të prodhojnë një të ngjashëm me Kur'anin, nuk do të munden, madje edhe nëse e ndihmojnë njëri tjetrin”***

(El-Isra, 17:88).

Që të fillojmë me shpalosjen e shembujve të mrekullueshëm numerik në lidhje me këtë varg, do të shkruajmë sërish ajetin në tërësi, duke numëruar shkronjat e secilës fjalë:

قُلْ (ق ل)	لُنَّ (ل ن)	اجْتَمَعَتْ (ا ج ت م ع ت)	الْإِنْسُ (ال ن س)	وَ (و)
2	3	6	5	1
الْجِنُّ (ال ج ن)	عَلَى (ع ل ي)	أَنْ (أ ن)	يَأْتُوا (ي أ ت و ا)	بِمِثْلِ (ب م ث ل)
4	3	2	5	4
هَذَا (ه — ذ ا)	الْقُرْآنِ (ال ق ر آ ن)	لَا (ل ا)	يَأْتُونَ (ي أ ت و ن)	
3	6	2	5	
بِمِثْلِهِ (ب م ث ل ه —)	وَ (و)	لَوْ (ل و)	كَانَ (ك ا ن)	
5	1	2	3	
بَعْضُهُمْ (ب ع ض ه — م)	لِبَعْضٍ (ل ب ع ض)	ظَهِيْرًا (ظ ه — ي ر ا)		
5	4	5		

Rezultati është pra numër 21 shifror 545321552634523415632, numër ky i cili praktikisht është shumëfish i numrit 7:

$$545321552634523415632 = 77903078947789059376 \times 7$$

### Tri segmentet e “ajetit sfidues”

Kjo nuk është e tëra sa i përket ajetit sfidues, ngaqë ai përbëhet nga tri pjesë:

1. *“Thuaj: Edhe po të mblidhen gjithë njerëzimi së bashku me xhinët”*

قُلْ لئن اجتمعت الانس و الجن

2. *“..të prodhojnë ndonjë ngjashmëri me Kur'anin, nuk do të mund të bëjnë këtë..”*

على أن يأتوا بمثل هذا القرآن لا يأتون بمثله

### 3. “..madje edhe po të ndihmojnë njëri tjetrin”.

ولو كان بعضهم لبعض ظهيرا

Tani do të ndajmë ajetin në tri pjesët strukturore të tij dhe do të vështrojmë numërimin e shkronjave të fjalëve në secilën pjesë të ndarë:

#### Pjesa e parë

Numërimi i shkronjave të secilës fjalë të pjesës së parë të ajetit, është si vijon:

الجن	و	الانس	اجتمعت	لئن	قل
4	1	5	6	3	2

$$415632 = 59376 \times 7$$

#### Pjesa e dytë

على	أن	يأتوا	بمثل	هذا	القرآن	لا	يأتون	بمثله
3	2	5	4	3	6	2	5	5

$$552634523 = 78947789 \times 7$$

#### Pjesa e tretë

و	لو	كان	بعضهم	لبعض	ظهيرا
1	2	3	5	4	5

Numri 545321 është shumëfish i dyfishtë i numrit 7:

$$545321 = 11129 \times 7 \times 7$$

## Përmbledhje

Që të kemi një përmbledhje të shkurtër të kësaj pjese, themi se:

Kur Zoti foli për zgjerimin e universit, jo vetëm që e vërtetoi shkencën bashkëkohore, por edhe gjuha e numrave e vërtetoi të njëjtën gjë.

Kur Ai foli për ruajtjen dhe mbrojtjen e Kur'anit të Shenjtë nga keqpërdorimi apo kopjimi, historia gjithashtu e vërtetoi këtë. Përkundër shumë tentimeve për t'a ndryshuar, Kur'ani gjatë gjithë kësaj kohe sërish mbeti i njëjti dhe atë si ndriçues për mbarë njerëzimin, dhe sot, gjuha e numrave na vërteton sërish të njëjtën gjë, se Kur'ani zbriti i mbrojtur për tërë njerëzimin; i pastër nga gabimet dhe i pandryshueshëm; zbriti nga Krijuesi i qiellit dhe tokës.

Duke përdorur gjuhën e numrave, edhe ne dëshmuam gjithashtu se kurrë askush nuk do të mund të formojë asnjë fjali të ndonjë ajeti të ngjashëm me atë në Kur'an. Jo vetëm kaq, por ne sapo shfaqëm edhe pamundësinë e shtimit të një shkronje të vetme!

Me të vërtetë, shembujt e ilustruar në këtë pjesë të librit janë dëshmi e qëndrueshme për çdo njërin që është skeptik ndaj Kur'anit, se ky Libër nuk ka asnjë mundësi për t'u kopjuar, por ajo që është për çdo admirim është se vet Libri deklaron për vetëbesimin e plotë të Tij, me faktin:

**“A e nuk e konsiderojnë ata Kur'anin (me kujdes)? Po të ishte nga ndonjë tjetër përveç Zotit, ata sigurisht do të gjenin në të shumë kundërthënie.”** [En-Nisa', 4:82]

# **MREKULLIA NUMERIKE E BESMELES DHE ÇDO AJETI NË KUR'AN-IN FISNIK**

## **PJESA -II-**

Parathënie	4
<b>KAPITULLI - I -</b>	
MREKULLIA NUMERIKE E AJETIT TË PARË NË KUR'AN (BESMELEJA)	9
<b>KAPITULLI - II –</b>	
MREKULLIA NDODHET NË ÇDO AJET DHE NË ÇDO FJALË	87



## RRETH AUTORIT

Abdud-Daim El-Kaheel është një studiues shkencor, ai është duke bërë thirrje për Zotin e Plotfuqishëm, ai është zbulues i mrekullive numerike të numrit shtatë në Kur'anin Fisnik, dhe është autor i më shumë se njëzet librave dhe tridhjetë sish të vogla rreth mrekullive në Kur'anin Fisnik dhe Sunnetin e Pejgamberit s.a.v.s.. Ai ka lindur në vitin 1966 në qytetin e Hims-it (Sirisë), ai ka mësuar përmendësh të gjithë Kur'anin Fisnik dhe ka një mënyrë të re për mësimin e Kur'anit fisnik përmendësh. Nëpërmjet këtij shkrimi ai do të paraqesë disa nga zbulimet e tij numerike në lidhje me numrin shtatë në Kur'anin Fisnik dhe kjo do të jetë në një mënyrë të thjeshtë.

Faqja e tij në internet është [www.kaheel7.com](http://www.kaheel7.com) ku ekzistojnë shumë hulumtime të rëndësishme rreth mrekullive të ndryshme në Kur'anin Fisnik.

E lusim All-llahun e Madhëruar që ta shpërblejë me shpërblimet më të plota në këtë botë dhe në botën e ardhme.